

1.	VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM.....	3
2.	RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË RADIOTELEVIZIVE PUBLIKE DHE PRIVATE NË PËRPUTHJE ME KUADRIN LIGJOR.....	5
2.1	Vendimmarrja e KKRT-së, licencimi dhe ecuria e operatorëve të licencuar.....	5
2.2	Sanksionet ndaj subjekteve	10
2.3	Ekzekutimi i vendimeve të KKRT-së.....	11
2.4	Çështjet gjyqësore.....	12
2.5	Respektimi i të drejtave të transmetimit.	14
3	PROGRAMACIONI	20
3.1.	Mbi përmbajtjen dhe etikën e programeve	20
3.2	Dukuri të programeve informative	23
3.3	Ligjshmëria në transmetimin e reklamave	30
3.4	Mbi regjistrimin dhe monitorimin e reklamave	33
4.	RRJETET E TRANSMETIMIT DHE MBULIMI ME SINJAL I ZONAVE TË LICENCIMIT	36
4.1.	Planifikimi i spektrit të frekuencave.....	36
4.1.1.	Planifikimi i rrjeteve televizive numerike	36
4.1.2	Koordinimi me Italinë	37
4.1.2.1	Koordinimi i frekuencave	38
4.1.3	Koordinimi me Greqinë	39
4.1.4	Shfrytëzimi i dividendit digjital për shërbime të tjera të telekomunikacioneve.....	39
4.1.5	Planifikimi i bandës FM	43
4.1.5.1	Gjendja.....	43
4.2	Rregullimi i spektrit FM.....	43
4.2.1	Riorganizimi i frekuencave të zonës së Tiranës.....	43
4.2.2	Rregullimi i shfrytëzimit të spektrit FM në territorin e Republikës	44
4.3	Planifikimi i rrjeteve analoge.....	44
4.3.1	Puna për planifikimin e frekuencave analoge (radio e tv), për licencimin e operatorëve të rinj dhe përmirësimin e mbulimit të operatorëve analogë ekzistues.	44
4.4	Monitorimi i shfrytëzimit të spektrit të frekuencave	46
4.4.1	Operatorë radiofonikë privatë vendorë që kanë pasur ndërprerje të shpeshta të transmetimit.....	47
4.5	Transmetimet aktuale (problematikat)	47
4.6	Operatorët	51
4.6.1	Operatorët radio e televizivë që mbështeten në rrjete tokësore analoge.....	51
4.6.1.1	Televizioni publik	52
4.6.1.2	Operatorët privatë kombëtarë.....	56
4.6.1.2.1	Operatori kombëtar TV Klan.....	58
4.6.1.2.2	Operatori kombëtar TV Top Channel	61
4.6.1.3	Operatorët privatë vendorë	64
4.6.1.4	Interferenca ndaj shërbimeve të tjera shkaktuar nga operatorë Radiotelevizivë.....	65
4.7	Përgatitjet për transmetimet numerike	66
4.7.1	Puna përgatitore për zbatimin e projektit të strategjisë së kalimit të plotë në transmetimet numerike.....	66
4.8	Detyrat për Radiotelevizionin Shqiptar	66
4.9	Detyrat për operatorët ekzistues historikë analogë.....	69
4.10	Detyrat për operatorët ekzistues analogë privatë lokalë	70

5.	MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE,	
	MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE PUBLIKUN	72
5.1.	Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe administrative	72
5.2.	Marrëdhëniet me jashtë	74
5.3.	Ecuria e zbatimit të projektit “Televizioni digjital i Europës Juglindore”	77
5.4.	Marrëdhëniet me publikun dhe grupet e interesit	78
6.	BUXHETI DHE REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË	81
6.1.	Realizimi i objektivave kryesore të punës	81
6.2.	Gjobat	87
6.3.	Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve	87
7.	KONKLUZIONE.....	88
8.	ANEKSET	89
	Aneksi 1	89
	Aneksi 2.....	99
	Aneksi 3 - Mbulimi i operatorëve televizivë (Volumi 1)	
	Aneksi 4 - Mbulimi i operatorëve radio (Volumi 2)	

1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Gjatë vitit 2012, me rëndësi të madhe në fushën e mediave audiovizive ishte miratimi nga Këshilli i Ministrave i “Strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në atë numerike”. Kjo Strategji parashikon objektivat kryesore dhe parimet e kalimit, formulon rolin e shtetit dhe të strukturave përkatëse të administratës shtetërore në krijimin e kushteve të kalimit në sistemin numerik, vlerësimin e situatës ekzistuese teknike dhe ligjore të peizazhit audio-vizual shqiptar si dhe përcakton hapat, procedurat dhe afatet e kalimit brenda datës 17 Qershor 2015. Së bashku me këtë strategji, është miratuar edhe Plani i Veprimit, në të cilën janë parashikuar masat konkrete, afatet e realizimit si dhe kostot financiare që kërkon zbatimi i tyre.

Strategjia e kalimit nga transmetimet analoge në atë numerike përcakton se digjitalizimi do të implementohet qark pas qarku, që nënkupton se nuk mbetet shumë kohë për ta filluar procesin në Shqipëri.

Duke pasur parasysh angazhimet dhe rolin e institucionit të KKRT-së në procesin e zbatimit të strategjisë së digjitalizimit, gjatë muajit qershor 2012, me urdhër të Kryetarit të KKRT-së, u ngrit grupi i punës i cili u angazhua në hartimin e një plani veprimi, si dhe në ndjekjen dhe zbatimin e masave për të cilat është përgjegjës ky institucion.

Për vetë faktin se për të realizuar një kalim të suksesshëm në transmetimet numerike është i nevojshëm një kuadër i plotë ligjor në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, edhe gjatë vitit 2012, KKRT-ja është përpjekur maksimalisht të propozojë dhe të sugjerojë ndryshime konkrete të projektligjit “Për median audiovizuale në Republikën e Shqipërisë”, që po diskutohet në Komisionin Parlamentar të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik. Miratimi sa më i shpejtë nga Kuvendi i Shqipërisë i këtij projektligji do t’i hapte rrugën nisjes së procesit të kalimit në sistemin numerik.

Gjatë gjithë vitit raportues KKRT-ja, në zbatim të detyrave të përcaktuara nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për vitin 2011” është përpjekur që të realizojë ato angazhime dhe objektiva kryesore që lidhen me ecurinë e institucionit, zbatimin e kuadrit ligjor ekzistues, përshpejtimin e reformës ligjore, nisjen e punës për fillimin e zbatimit të strategjisë së kalimit nga sistemi analog në atë numerik, luftën kundër transmetimeve pa të drejta, respektimin e normave etike dhe morale në transmetimet radiotelevizive etj.

Gjithashtu, edhe gjatë vitit 2012, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, si partner në projektin “**Televizioni Digjital i Evropës Juglindore (SEE Digi TV)**”, brenda Programit të Bashkëpunimit Ndërnacional të Evropës Juglindore, të financuar nga Bashkimi Evropian, ka realizuar një sërë aktivitetesh që lidhen me aspektin ligjor, teknik, ekonomik dhe ndërgjegjësimit të publik, për sa i përket procesit dhe fazave të kalimit në sistemin numerik. Kontributet e dhëna nga KKRT-ja janë tashmë pjesë e dokumenteve rajonale të hartuar në kuadër të këtij projekti.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka miratuar një tërësi aktesh dhe vendimesh, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në fushën e medias dhe në përmirësimin e peizazhit audiovizual.

Më konkretisht, veprimtaritë e kryera jepen me hollësi në këtë Raport.

**2. RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË
RADIOTELEVIZIVE PUBLIKE DHE PRIVATE NË PËRPUTHJE ME
KUADRIN LIGJOR**

2.1 Vendimmarrja e KKRT-së, licencimi dhe ecuria e operatorëve të licencuar.

Gjatë vitit 2012, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka miratuar gjithsej 175 vendime.

Kuadri ligjor bazë, që rregullon veprimtarinë radiotelevizive, publike e private, në Republikën e Shqipërisë, mbështetet në ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për Radion dhe Televizionin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 9742, datë 28.05.2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore në bazë dhe zbatim të tyre. Në ushtrim të kompetencave të veta ligjore, vendimmarrja e KKRT-së është realizuar përmes dhënies së licencave për transmetime radiotelevizive, rinovimit të licencave të subjekteve të ndryshëm, shqyrtimit të ankesave të tyre ndaj sanksioneve për kundërvajtje administrative, por edhe çështje të tjera që përfshihen brenda veprimtarisë së KKRT-së.

Në raport me vitet e kaluara, gjatë vitit 2012, rezulton se ka pasur një numër më të vogël kërkesash për t’u licencuar si subjekte për të ushtruar veprimtari radiotelevizive.

Gjatë vitit raportues KKRT-ja ka licencuar gjithsej 16 subjekte radiotelevizive ku, kryesisht, numrin më të madh e zënë operatorët televizivë kabllorë.

Licencimet janë si më poshtë:

1. Operatorë televizivë privatë analogë vendorë (2 subjekte), operatorë radiofonikë analogë privatë vendorë (5 subjekte), operatorë radiofonikë privatë me përsëritës (1 subjekt) dhe operatorë televizivë privatë kabllorë (8 subjekte), konkretisht si më poshtë vijon:

TV vendorë

1. TV vendor “AdriaMed” (zgjerim zone licencimi në rrethin Kavajë, qarqet Fier dhe Vlorë);
2. TV vendor “Veleçiku” (Rrethi Shkodër);

Radio vendore

1. Radio “Travel” (Qarqet Fier-Vlorë);
2. Radio “Motiv” (Rrethi Shkodër);
3. Radio “Capital” (Rrethet Tiranë-Durrës);

4. Radio “Glob” (Qyteti Berat);
5. Radio “City FM” (Qarku Korçë).

Radio me përsëritës

1. “CRI Radio e Jashtme e Kinës”.

TV kabllorë

1. TV kabllor “Ordea” (Rrethi Devoll dhe Komuna Liqenas);
2. TV kabllor “Lin” (Fshati Lin);
3. TV kabllor “Manastiri” (Komuna Kolonjë);
4. TV kabllor “Ir-Gen” (Bashkia Libohovë, zgjerim zone);
5. TV kabllor “Fier-Shegan” (Komuna Fier-Shegan);
6. TV kabllor “Arten” (Komunat Bubullimë dhe Gradishtë);
7. TV kabllor “Dire” (Qyteti Kuçovë);
8. TV kabllor “Apoll Net” (Qyteti Fier).

Gjithashtu, gjatë këtij viti janë miratuar dhe një numër i konsiderueshëm kërkesash për rinovim licence (43 subjekte), në mbështetje të ligjit nr. 8410, si dhe në mbështetje e në zbatim të procedurave të përcaktuara në Rregulloren e KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë".

Radiot dhe televizionet vendore dhe kabllorë të cilave, me vendim të KKRT-së, iu është rinovuar licenca, janë si më poshtë vijon:

Rinovim licencash

1. TV Bajram Curri
2. TV Era
3. TV Fokus
4. TV Lobi
5. TV Ora News
6. TV Super Sonic
7. TV Margit
8. TV Saranda
9. TV Rozafa Motiv
10. TV Antena Nord
11. Radio AS
12. Radio Idea
13. Radio Travel
14. Radio DJ 96.1
15. Radio Egnatia
16. Radio Jehona

17. Radio Logos
18. Radio Ora
19. Radio Kiss
20. Radio Spartak SM
21. Radio Lushnja
22. Radio Club Alsion
23. Radio Jug
24. Radio Scan
25. Radio Alfa&Omega
26. Radio World Family
27. Radio Ime
28. Radio Klan
29. Radio Love
30. Radio Fieri
31. Radio Ngjallja
32. Radio Energy
33. Radio Val' e Kaltër
34. TV kabllor KL-ED
35. TV kabllor IR-GEN
36. TV kabllor APT
37. TV kabllor KAM
38. TV kabllor Delvina
39. TV kabllor Tepelena Sat
40. TV kabllor Eri A&A
41. TV kabllor Erzeni
42. TV kabllor Blu
43. TV kabllor Ura Vajgurore

Gjatë procedurës administrative të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjektet për dhënien e licencave, apo rinovimin e tyre, është mbajtur parasysh respektimi i kushteve të përcaktuara në ligj dhe në licencë nga ana e subjekteve radiotelevizivë që ushtrojnë veprimtari radiotelevizive. Kështu, gjatë shqyrtimit të kërkesave për rinovimin e licencave është realizuar verifikimi i respektimit të kriterëve të mëposhtme, si realizimi i mbulimit të zonës së licencimit, (sipas territorit dhe sipas popullsisë) respektimi i kushteve të licencës për sa i përket programeve, detyrimet financiare për periudhën e ushtrimit të aktivitetit, si dhe zbatimi i legjislacionit në përgjithësi dhe veçanërisht i ligjit nr. 8410, dt. 30. 09. i ndryshuar.

Krahas vendimeve të mësipërme për dhënie dhe rinovime licencash, KKRT-ja, mbështetur në të drejtën që ka për kontrollin e veprimtarisë radiotelevizive, ka marrë vendime për heqje, mosrinovime, apo mosdhënie licence për disa subjekte, të cilat nuk kanë respektuar kushtet dhe kriteret të përcaktuara në ligj dhe licencë.

Mosdhënie licencash

1. " Radio Apollon " (kërkesë për licencim)

Heqje ose pavlefshmëri licencash

1. "Radio Vesa"
2. "TV kabllor Alfa"
3. "Radio 4"
4. "TV kabllor Progres"

Në përputhje me ligjin nr. 8410 datë 30.09.1998, i ndryshuar, neni 7 pika 5 si dhe mbështetur në Kodin e Procedurave Administrative, vendimet e KKRT-së për dhënien dhe heqjen e licencave janë botuar në Fletoren Zyrtare. **Konstatohet se, gjatë vitit 2012, nuk ka pasur ankesa nga ana e subjekteve të interesuar, lidhur me vendimet e KKRT-së për mosdhënie licence.**

Në ushtrim të kompetencave ligjore nga ana e KKRT-së janë marrë në shqyrtim kërkesat dhe njoftimet e paraqitura nga subjektet e licencuar për ndryshimin e të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës. Ky është detyrim i parashikuar në nenin 30 "Detyrimi për ndryshimin e të dhënave" të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar. Sipas këtij neni, subjektet kanë detyrimin të njoftojnë KKRT-në për çdo ndryshim të të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës si: ndryshimet në pronësi, në administrim apo drejtues të shoqërisë, emërtimin e radios ose televizionit, ndryshime në programet që transmeton, selinë apo adresën e subjektit dhe të tjera kushte që kanë ndryshuar te subjekti që nga momenti i licencimit. Ky nen krijon mundësinë që KKRT-ja të kontrollojë përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe kushteve të licencës nga ana e subjekteve edhe kur ndryshojnë ndonjë nga të dhënat e tyre.

Neni 22, "Vlefshmëria e Licencës" i ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, parashikon patjetërsueshmërinë e licencës së transmetimit pa miratimin e KKRT-së, duke mundësuar kontrollin dhe transparencën nga ana e KKRT-së në pronësinë e licencës. Në këtë mënyrë realizohet roli mbikëqyrës i KKRT-së, në kufizimet ligjore të pronësisë, që janë masat që sigurojnë dhe parandalojnë monopolet, koncentrimin dhe promovojnë pluralizmin e medias.

Gjatë vitit 2012, KKRT-ja ka shqyrtuar, duke kryer edhe vendimmarrjet përkatëse, kërkesat e 12 subjekteve për shqyrtimin e ndryshimit të të dhënave të paraqitura. Më konkretisht:

1. Me Vendimin nr. 21, datë 28.02.2012, KKRT-ja ka miratuar ndryshimet e të dhënave në licencën e shoqërisë “Radio Link” sh.p.k., licencuar për subjektin radiofonik privat vendor Radio DJ 96.1. (Ndryshime në strukturën e ortakëve të shoqërisë);
2. Me Vendimin nr. 22, datë 28.02.2012, KKRT-ja ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë “Antena” sh.p.k., licencuar nga KKRT-ja për radion private vendore “Radio Love” (Ndryshime në strukturën e ortakëve të shoqërisë);
3. Me Vendimin nr. 50, datë 26.03.2012, KKRT-ja ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë “TV Ballkan” sh.a., licencuar nga KKRT-ja për TV vendor “TV A1 Report” (Ndryshim i administratorit dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë);
4. Me Vendimin nr. 66, datë 13.04.2012, KKRT-ja ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë “TV Ballkan” sh.a., licencuar nga KKRT-ja për TV vendor “TV A1 Report” (Miratimi i ndryshimit të logos së subjektit televiziv);
5. Me Vendimin nr. 82, datë 24.05.2012, KKRT-ja ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë “Media Motiv” sh.a., licencuar nga KKRT-ja për TV vendor “TV Media Motiv” (Miratimi i ndryshimit të logos së subjektit televiziv).
6. Me vendimin nr. 121, datë 31.08.2012, KKRT-ja ka miratuar ndryshimin e të dhënave në subjektin person fizik Emiljano Hoxhaj, licencuar nga KKRT-ja për “TV Glob” (Miratim i ndryshimit të pronësisë së televizionit);
7. Me Vendimin nr. 105, datë 27.07.2012, KKRT-ja ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë “Media Vizion” sh.a., licencuar nga KKRT-ja për subjektin televiziv privat satelitor “TV Vizion +” (Miratimi i ndryshimeve në strukturën e aksionerëve, administratorit dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë);
8. Me Vendimin nr. 122, datë 31.08.2012, KKRT-ja ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë “Univers” sh.p.k., licencuar për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Univers” (Miratimi i ndryshimeve në strukturën e ortakëve të shoqërisë dhe administratorit të shoqërisë);
9. Me Vendimin nr. 134, datë 24.09.2012, KKRT-ja ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë “TV Vora - S3” sh.p.k., licencuar për subjektin televiziv privat kabllor “TV Vora S3” (Miratim i ndryshimit të formës ligjore të subjektit nga person fizik në person juridik dhe ndryshim në pronësinë e subjektit);
10. Me Vendimin nr. 144, datë 31.10.2012, KKRT-ja ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë “TV Vlora Cable” sh.p.k., licencuar për subjektin televiziv privat kabllor “TV Kabllor Vlora Cable” (Miratim i ndryshimit të formës ligjore

të subjektit nga person fizik në person juridik dhe ndryshim në pronësinë e subjektit).

KKRT-ja vëren një ndërgjegjësim më të madh të operatorëve radiotelevizivë në respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga nenet 22 “Vlefshmëria e licencës” dhe 30 “Detyrimi për njoftimin e ndryshimeve” të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2.2. Sanksionet ndaj subjekteve

Një ndër detyrat funksionale të KKRT-së është kontrolli i respektimit të kushteve të licencës nga subjektet që ushtrojnë veprimtari radiotelevizive. Mbështetur në nenin 137/1 “Inspektimi i veprimtarisë së të licencuarit” të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, të ndryshuar, KKRT-ja inspekton veprimtarinë e të licencuarit. KKRT-ja ka, gjithashtu, kompetencë të vendosë sanksione sipas nenit 137 “Sanksionet” për subjektet që veprojnë në kundërshtim me dispozitat ligjore (neni 7, pika 11, e ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, të ndryshuar).

Inspektorët vendosin gjoba dhe, bazuar në nenet 137/4 “Gjobat” dhe 137/3 “Kundërvajtjet administrative” të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, mund t’i propozojnë Këshillit: reduktimin, pezullimin ose heqjen e licencës së një subjekti. Në zbatim të këtyre dispozitave janë kryer inspektime të shpeshta tek operatorët e licencuar, por gjithashtu janë konstatuar edhe dalje në transmetim të subjekteve të ndryshëm pa licencë. Në rastet kur janë konstatuar shkelje të ligjit dhe kushteve të licencës, ndaj subjekteve kundërvajtës janë ndërmarrë sanksionet përkatëse.

Shkeljet më të prekshme, gjatë vitit 2012 kanë konsistuar në mosrespektimin e të drejtës së transmetimit, mosnjoftimin e ndryshimeve të ndodhura te subjektet radiotelevizive, daljen në transmetim pa autorizimin, licencimin e KKRT-së, të operatorëve privatë radiotelevizivë kabllorë, etj. Theksojmë se, përveç sa më sipër, gjatë vitit 2012 janë ushtruar kontrole të shpeshta edhe ndaj subjekteve të licencuar për të shpërndarë sinjal televiziv, me qëllim respektimin e kushteve të licencës lidhur me përmbajtjen e programeve, si dhe kontrollin e detyrimit ligjor për ruajtjen e lajmeve apo reklamave të transmetuara. Krahas sanksioneve me gjobë, në rastet kur janë evidentuar subjekte që kanë dalë në transmetim pa licencë, janë nxjerrë dhe urdhrat përkatës që i janë dërguar për zbatim Drejtorive Rajonale Tatimore si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve apo sekuestrimin e pajisjeve të këtyre subjekteve.

Konkretisht, sanksionet me gjobë pasqyrohen **në Aneksin 1** të këtij Raporti.

2.3. Ekzekutimi i vendimeve të KKRT-së

Një tjetër çështje, e cila edhe në vitin raportues ka hasur vështirësi, është ekzekutimi i vendimeve të KKRT-së. Siç është theksuar vazhdimisht, zgjidhja e këtij problemi ndikon drejtpërdrejt në ecurinë normale të institucionit. Kapacitetet teknike dhe administrative të KKRT-së, nuk mund të mbulojnë edhe ekzekutimin e vendimeve të miratuara prej këtij të fundit, pasi organika e institucionit të KKRT-së nuk ka struktura të veta të ngarkuara për ekzekutimin e vendimeve. Nga ana tjetër, ligji nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, për zbatimin e tyre ka parashikuar bashkëpunimin me organe të tjera. Më konkretisht, vendimet e KKRT-së, ekzekutimi i të cilave kërkon patjetër mbështetjen e institucioneve të tjera janë vendimet për heqjen e licencave apo vendimet për mbylljen e stacioneve transmetuese dhe sekuestrimin e pajisjeve transmetuese të subjekteve të ndryshme të licencuara apo jo.

Përveç sa më sipër, edhe vjelja e detyrimeve financiare (taksë për shërbimet radiotelevizive dhe pagesë për licencë e subjekteve radiotelevizivë), kërkon asistencën e organeve tatimore.

Sipas legjislacionit në fuqi, referuar në mënyrë specifike nenit 137/5 “Bashkëpunimi me organe të tjera”, të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, organet shtetërore të ngarkuara për ekzekutimin e vendimeve të KKRT-së, duke pasur parasysh edhe ndryshimet në ligjin “Për procedurat tatimore”, janë Drejtoritë Rajonale Tatimore. Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, midis KKRT-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit e cila ka si objekt rregullimin e bashkëpunimit midis palëve me qëllim mbështetjen e strukturave të KKRT-së, lidhur me ekzekutimin e vendimeve të marra ndaj subjekteve që shkelin legjislacionin e fushës.

Pavarësisht nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, ku janë përcaktuar modalitetet e detyrimit e secilit prej palëve nënshkruese, edhe gjatë vitit 2012, është trashëguar problemi i ekzekutimit të vendimeve të KKRT-së. Në zbatim të marrëveshjes, nga ana e KKRT-së, si dhe në zbatim të vendimeve të kësaj të fundit apo vendimeve të inspektorëve të kthyer në tituj ekzekutivë, janë njoftuar shkresërisht Drejtoritë Rajonale Tatimore, duke ofruar rast pas rasti edhe ndihmën e saj, nëpërmjet prezencës fizike të inspektorëve të KKRT-së. Por, ashtu si edhe në vitet e mëparshme, gjatë vitit raportues, pjesa dërmuese e vendimeve të KKRT-së nuk janë ekzekutuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke sjellë efekte negative për situatën financiare të KKRT-së si edhe për uljen e autoritetit të KKRT-së si organ rregullator në fushën audiovizuale dhe për pasojë edhe në mosgarantimin e objektivave që ka KKRT-ja për garantimin e konkurrencës së ndershme në tregun mediatik shqiptar.

Në dallim nga vitet e kaluara, gjatë vitit 2012, është konstatuar një numër më i ulët i subjekteve që kanë dalë në transmetim në efir pa u pajisur me licencën përkatëse nga

KKRT-ja. Pavarësisht kësaj, mbështetur në nenet 10/a “Kompetencat e Kryetarit të KKRT-së”, 137/2 “Bllokimi i pajisjeve” dhe 137/5 “Bashkëpunimi me organe të tjera”, të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, janë miratuar urdhrat për bllokimin me vulosje dhe sekuestrimin e pajisjeve transmetuese, si më poshtë:

1. Urdhër nr. 178, datë 03.08.2012 “Për sekuestrimin e pajisjeve të televizionit numerik tokësor ‘Saranda’, në pronësi të z. Thodhori Dukshi”;
2. Urdhër nr. 90, datë 07.05.2012 “Për sekuestrimin e pajisjeve televizionit kabllor të palicencuar në komunën Gradisht, në pronësi të z. Altin Ziu”;
3. Urdhër nr. 91, datë 07.05.2012 “Për sekuestrimin e pajisjeve televizionit kabllor të palicencuar në komunën Gradisht (Seman, Fier), në pronësi të z. Artan Zhupani”;
4. Urdhër nr. 89, datë 07.05.2012 “Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të televizionit privat kabllor të palicencuar, në pronësi të z. Taulant Qëndro, në qytetin e Gjirokastrës”;
5. Urdhër nr. 92, datë 07.05.2012 “Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të televizionit privat kabllor të palicencuar, në komunën Karbunarë, Lushnjë”;
6. Urdhër nr. 182, datë 27.08.2012 “Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të televizionit privat kabllor të palicencuar, në pronësi të z. Vlash Kola, Milot”;
7. Urdhër nr. 183, datë 27.08.2012 “Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të televizionit privat kabllor të palicencuar, në Rubik, bashkia Rrëshen”;
8. Urdhër nr. 184, datë 27.08.2012 “Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të televizionit privat kabllor të palicencuar, në Qerret, Kavajë”;
9. Urdhër nr. 185, datë 27.08.2012 “Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të televizionit privat kabllor të palicencuar, në Gërdec, Vorë”;
10. Urdhër nr. 213, datë 01.10.2012 “Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të televizionit privat vendor në pronësi të z. Jani Grabova, në qytetin e Fierit”;
11. Urdhër nr. 229, datë 23.10.2012 “Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të televizionit privat kabllor të palicencuar, në pronësi të z. Glendi Qeska, në komunën Xarë, rrethi Sarandë”;
12. Urdhër nr. 230, datë 23.10.2012 “Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të televizionit privat kabllor të palicencuar, në komunën Konispol, rrethi Sarandë”;
13. Urdhër nr. 231, datë 23.10.2012 “Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të televizionit privat kabllor të palicencuar, në fshatin Shalës, rrethi Sarandë”.

2.4. Çështjet gjyqësore

Subjektet të cilët, mbështetur në dispozitat e ligjit organik, kanë ushtruar të drejtën e ankimit administrativ, rast pas rasti, më tej kanë investuar edhe organet gjyqësore sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Gjatë vitit 2012, KKRT-ja ka qenë palë e paditur në procese gjyqësore për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme, kryesisht me operatorë radiotelevizivë. Gjatë vitit 2012, janë ankimuar në gjykatë vendimet e KKRT-së lidhur me miratimin e sanksioneve ndaj subjekteve radiotelevizivë dhe vendimeve për mosrinovimin e licencave etj.

Si person juridik, edhe KKRT-ja, në disa raste, ka vënë në lëvizje gjykatën në cilësinë e palës paditëse, kryesisht me palë të paditur përmbaarues privatë gjyqësorë, apo subjekte shkelës së fushës.

KKRT, aktualisht, është e përfshirë në total në 46 procese gjyqësore, pjesa më e madhe e të cilave janë të trashëguara nga vitet paraardhëse, por zgjatja e procedurave gjyqësore ka bërë që gjykimi i tyre të vazhdojë dhe gjatë vitit 2012.

Pasqyrimi në mënyrë të përmbledhur i çështjeve gjyqësore në gjykim, në tre shkallët e gjyqësorit, të ekzekutuara dhe të përfunduara gjatë vitit 2012, është si më poshtë vijon:

A. Çështjet gjyqësore në gjykim, në gjykatat e shkallës së parë, gjatë vitit 2012, ku është palë KKRT-ja, janë gjithsej 18, nga të cilat:

- 9 çështje me objekt anulimin e akteve administrative, Vendimeve të KKRT-së për vendosjen e sanksioneve me gjobë;
- 2 çështje me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbaarimore;
- 2 çështje me objekt anulimin e akteve administrative, Vendimeve të KKRT-së për pavlefshmëri (1) dhe mosrinovim (1) licence;
- 1 çështje me objekt anulimin e urdhrit për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve transmetuese;
- 1 çështje me objekt anulim akti administrativ, Vendim i KKRT-së për ndërprerje transmetimi reklame;
- 1 çështje me objekt rivendosje në afat;
- 1 çështje me objekt shpërblim dëmi;
- 1 çështje me objekt rillogaritje pensioni suplementar.

KKRT është palë e paditur në 16 çështje , në 1 çështje është palë paditëse dhe në 1 çështje është palë e tretë.

B. Çështjet gjyqësore në gjykim në gjykatat e apelit gjatë vitit 2012, ku është palë KKRT-ja, janë gjithsej 18, nga të cilat :

- 5 çështje me objekt anulimin e akteve administrative, Vendimeve të KKRT-së për vendosjen e sanksioneve me gjobë;
- 4 çështje me objekt anulimin e akteve administrative, Vendimeve të KKRT-së për mosrinovim (1), heqje (1) dhe reduktim (2) licence;
- 4 çështje me objekt marrëdhënie pune;
- 3 çështje me objekt lëshimin e urdhrave të ekzekutimit;
- 1 çështje me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbaarimore;
- 1 çështje me objekt shlyerje detyrimi kontraktor.

KKRT është palë e paditur në 13 çështje, në 4 çështje është palë paditëse (ose kërkuese) dhe në 1 çështje është palë e tretë.

C. Çështjet gjyqësore në gjykim në Gjykatën e Lartë, për të cilat është ushtruar rekurs gjatë vitit 2012, ku është palë KKRT-ja, janë gjithsej 10, nga të cilat:

- 4 çështje me objekt anulimin e akteve administrative, Vendimeve të KKRT-së për vendosjen e sanksioneve me gjobë;
- 5 çështje me objekt marrëdhënie pune;
- 1 çështje me objekt anulimin e akteve administrative, Vendimeve të KKRT-së për heqje të licencës;

Për 8 nga çështjet e mësipërme është ushtruar rekurs nga ana e KKRT-së, ndërsa për 2 është ushtruar nga palët e tjera në gjykim.

D. Çështjet gjyqësore me objekt marrëdhënie pune të ekzekutuara nga KKRT-ja, gjatë vitit 2012, janë gjithsej 8, nga të cilat:

- 7 çështje janë ekzekutuar në mënyrë vullnetare;
- 1 çështje është ekzekutuar në mënyrë të detyrueshme.

E. Çështjet gjyqësore të përfunduara gjatë vitit 2012, ku është palë KKRT janë gjithsej 14, nga të cilat:

- 6 çështje me objekt anulimin e akteve administrative, Vendimeve të KKRT-së;
- 2 çështje me objekt lëshimin e urdhrave të ekzekutimit;
- 1 çështje me objekt lirim dhe dorëzim sendi objekt gjykimi (ish godina Hotel “Drini”);
- 1 çështje me objekt anulim procedure konkurrimi;
- 1 çështje me objekt shpërblim dëmi;
- 1 çështje me objekt dëmshpërblim page;
- 1 çështje me objekt përmbushje detyrimi kontraktor;
- 1 çështje me objekt kërkesë për shtyrje të afatit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

5 nga çështjet e mësipërme kanë përfunduar në favor të KKRT-së (3 në gjykatë të shkallës së parë dhe 2 në Gjykatën e Apelit); për 6 çështje është vendosur pushimi i gjykimit, nxjerrja jashtë gjykimi, apo kthimi i akteve (5 në gjykatat e shkallës së parë dhe 1 në Gjykatën e Lartë); 3 çështje të tjera kanë përfunduar për shkak të mosushtrimit të ankimit nga palët në gjykim (2 në Gjykatë të Lartë dhe 1 në Gjykatën e Apelit).

2.5. Respektimi i të drejtave të transmetimit.

Mbrojtja dhe respektimi i pronësisë intelektuale përbën një nga detyrimet që Shqipëria duhet të plotësojë në kuadër të akteve ndërkombëtare të cilat janë nënshkruar nga ana e saj. Një nga momentet kyçe të rrugës së vendit drejt integritetit europian është nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, marrëveshje e cila i ka kushtuar një vëmendje të

posaçme mbrojtjes që Shqipëria duhet t'i sigurojë pronësisë intelektuale. Më konkretisht, neni 73 i saj parashikon që Shqipëria duhet të marrë masat e duhura për të siguruar një nivel mbrojtjeje për pronësinë intelektuale të njëjtë me atë të siguruar nga vendet e BE. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit është një nga institucionet i cili ka si detyrë funksionale monitorimin dhe mbrojtjen e një prej degëve të pronësisë intelektuale, konkretisht të të drejtave të autorit. KKRT-ja vepron në një fushë të kufizuar për mbrojtjen e të drejtave të autorit, specifikisht të drejtat e transmetimit. Mbrojtja e të drejtave të autorit dhe lufta ndaj piraterisë radiotelevizive është detyrim ligjor që rrjedh nga ligji organik i KKRT-së.

Ligji nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 40/1 "Detyrimi për depozitimin e dokumentacionit të së drejtës së transmetimeve", parashikon se *"Operatorët radiotelevizivë transmetojnë programe të prodhuara nga ata vetë, në bashkëprodhim me të tjerë, me marrëveshje me kontratë shitjeje, shkëmbimi ose dhurimi. Operatorët radiotelevizivë detyrohen të identifikojnë, me figurë ose me zë, si dhe të dokumentojnë programet e përcaktuara në paragrafin e parë, duke përcaktuar llojin e programit, realizuesin dhe zotëruesin e pronësisë mbi programin. Operatorët radiotelevizivë të licencuar detyrohen të depozitojnë pranë Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit dokumentacionin që vërteton se zotërojnë të drejtën e transmetimit të programeve me marrëveshje me kontratë shitjeje, shkëmbimi ose dhurimi"*.

Në bazë dhe për zbatim të ligjit organik të KKRT-së, kjo e fundit ka nxjerrë Rregulloren "Mbi depozitimin e dokumentacionit për të drejtën e transmetimit" (me Vendimin nr. 165, datë 29.08.2003). Bazuar në pikën 3 e në vijim të kësaj rregulloreje *"Të gjithë subjektet radiotelevizivë të depozitojnë pranë KKRT-së dokumentacionin e të drejtës së transmetimeve të programeve radiotelevizive, qofshin këto programe të prodhuara vetë, në bashkëprodhim me të tjerë apo me marrëveshje (kontrate shitje, shkëmbimi, dhurimi). Kur është e nevojshme, duhet të depozitohet dhe marrëveshja origjinale nga e cila buron e drejta e shitjes, shkëmbimit apo dhurimit"*. Kjo rregullore përcakton procedurat dhe mënyrat e dorëzimit të dokumentacionit lidhur me të drejtat e transmetimit pranë KKRT-së.

Shkelja apo mosrespektimi i dispozitave të mësipërme, nga ana e subjekteve radio-televizive përbën kundërvajtje administrative dhe KKRT-ja, në mbështetje të pikës 7 të nenit 137/4, të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, ka të drejtë të vendosë *"Gjobë nga 200.000 deri në 1.000.000 lekë, kur transmetojnë programe që nuk i kanë prodhuar vetë dhe për të cilat nuk kanë marrëveshje, kontratë shitjeje, shkëmbimi ose dhurimi nga subjektet e tjera radiotelevizive, prodhuesit apo shpërndarësit e autorizuar te tyre. Gjoka vendoset nga KKRT-ja me nismën e saj ose pas ankimit të operatorëve."*

Përsëritja e kësaj shkeljeje më shumë se 5 herë dënohet me uljen deri në 50 përqind të afatit të licencës. Në rast ripërsëritjeje shkelja ndëshkohet me heqjen e licencës. Ndëshkimi me gjobat e mësipërme është i vlefshëm edhe për Radiotelevizionin Shqiptar”.

Me qëllim arritjen e një mbrojtje sa më efikase, si dhe për të pasur sa më shumë rezultate në luftën ndaj piraterisë radiotelevizive, institucionet që janë të përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të autorit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën ndërmjet tyre. Në këtë kuadër, KKRT-ja dhe Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA), si institucion i krijuar me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të autorit, kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi. Ky Memorandum është nënshkruar më datë 28.09.2007 dhe parashikon mënyrat konkrete të bashkërendimit të veprimeve, konkretisht në mbështetje të pikës 4 të këtij memorandumi, dokumentacioni i të drejtave të transmetimit (kontratë shitje, shkëmbimi, dhurimi), **duhet të regjistrohet dhe certifikohet më parë në ZSHDA, e më pas të depozitohet në KKRT.**

Gjatë vitit 2012, KKRT-ja ka intensifikuar marrëdhëniet me institucionet e përmendura më sipër, duke bashkëpunuar në monitorimin dhe garantimin e respektimit të të drejtave të autorit, kryesisht përmes shkëmbimit të informacioneve që këto institucione zotërojnë.

Gjatë vitit 2012, ndër operatorët radiotelevizivë është vënë re një rritje e ndërgjegjësimit lidhur me detyrimet që ata kanë për respektimin e të drejtave të transmetimit/autorit. Subjektet që kanë autorizimet nga të 4-ta agjencitë e administrimit kolektiv (AMP, AKDIE, ALBAUTOR, FMAA) dhe vërtetimin nga ZSHDA-ja janë 22. Më konkretisht:

1. TV kabllor Bulqiza;
2. TV kabllor Irla;
3. TV kabllor Orikum;
4. TV kabllor Asparag;
5. TV kabllor Iliria;
6. TV kabllor Ura Vajgurore;
7. TV kabllor Krutja;
8. TV kabllor Toshkëz;
9. TV kabllor Vlora Cable;
10. TV kabllor Lapardha;
11. TV kabllor ARD & NET;
12. TV kabllor Mamurras;
13. TV kabllor Oreh;
14. TV kabllor Alfa Hajdini;
15. TV kabllor Manastiri;
16. TV kabllor Lin;
17. TV kabllor Arten;
18. TV vendor Bulqiza;

19. Radio Love;
20. Radio Eagle;
21. Radio DJ 96.1;
22. Radio Club FM.

Gjithashtu, 20 subjekte kanë autorizime nga njëra prej agjencive të administrimit kolektiv, 7 subjekte kanë autorizime me dy prej agjencive të administrimit kolektiv, dhe 2 subjekte kanë autorizime me tre prej agjencive të administrimit kolektiv si më poshtë vijon:

1. TV kabllor APT	AMP
2. TV kabllor S3	AMP
3. TV kabllor M Devolli	AMP, AKDIE
4. TV kabllor Korça	FMAA, AMP
5. TV kabllor Dushk	AMP
6. TV kabllor Tepelena SAT	AMP
7. TV kabllor Eri A&A	AMP
8. TV kabllor Danja	AMP, AKDIE
9. TV kabllor KAM	ALBAUTOR, AKDIE, AMP
10. TV kabllor Divjaka	AKDIE, AMP, FMAA
11. TV kabllor Egnatia	AMP
12. TV kabllor Star & Trio	ALBAUTOR
13. TV kabllor Tërbuf	AMP
14. TV kabllor Pupa	AMP
15. TV kabllor Lushnja	AMP, AKDIE
16. TV kabllor Maqellara	AKDIE
17. TV kabllor Bradsat	AMP
18. TV kabllor Xhaci	AMP, AKDIE
19. TV kabllor Apollnet	AMP
20. Radio Ime	ALBAUTOR (vërtetim ZSHDA)
21. Radio Boom Boom	AKDIE, AMP (vërtetim ZSHDA për AMP)
22. Radio Alfa & Omega	ALBAUTOR
23. Radio Kontakt	ALBAUTOR (vërtetim ZSHDA)
24. Radio Sport	AMP
25. Radio Euro Star Music	AMP
26. Radio Val' e Kaltër	AMP
27. Radio Logos	ALBAUTOR
28. Radio Scan	AMP
29. Radio Kiss	AMP, AKDIE (vërtetim ZSHDA)

Megjithatë, çështja e mosrespektimit të të drejtave të transmetimit në programet radiotelevizive është ende e pranishme. Ky fenomen është i shtrirë në të gjithë llojet e subjekteve, por mbetet më i theksuar sidomos në operatorët radiotelevizivë kabllorë dhe operatorët radiotelevizivë analogë vendorë. Ashtu siç është theksuar edhe më parë, monitorimi dhe kontrolli i operatorëve radiotelevizivë analogë vendorë mbetet një

shqetësim për KKRT-në, pasi sinjali i tyre nuk kapet nga studioja e monitorimit në KKRT.

KKRT-ja, gjatë gjithë vitit 2012, ua ka bërë të qartë të gjithë operatorëve radio-televizivë se dokumentacioni i të drejtave të transmetimit (kontratë shitjeje, shkëmbimi, dhurimi), para se të depozitohet në KKRT nga operatorët radiotelevizivë, duhet të jetë i regjistruar dhe certifikuar nga ZSHDA-ja. Me gjithë përpjekjet e bëra nga KKRT-ja, pjesa më e madhe e dokumentacionit të depozituar pranë kësaj të fundit vazhdon të jetë i paregjistruar dhe i pacertifikuar nga ZSHDA-ja.

Respektimi i të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit vazhdon të mbetet një çështje mjaft e ndjeshme, që sfidon KKRT-në dhe do të vazhdojë ta sfidojë edhe në të ardhmen e afërt. Kjo për shkak se pronësia intelektuale është një fushë e re në Shqipëri dhe praktika e konsoliduar lidhur me të mungon.

Studioja e monitorimit arrin të monitorojë vetëm subjektet që operojnë në zonën Tiranë-Durrës, ndërkohë që pjesa tjetër, pavarësisht kontrollit periodik nëpërmjet inspektimeve në të gjithë territorin e vendit e bën të pamundur kontrollin efektiv lidhur me respektimin e të drejtave të transmetimit.

Pavarësisht vështirësive, KKRT-ja, gjatë vitit 2012, ka intensifikuar inspektimet në terren, në të gjithë territorin e vendit, për të mbikëqyrur respektimin e të drejtave të transmetimit nga subjektet televizivë kabllorë. Si rezultat i kontrolleve të ushtruara gjatë gjithë vitit janë ndëshkuar me sanksionin e paralajmërimit dhe të gjobës një numër i konsiderueshëm televizioneesh kabllore dhe/ose vendore, të cilat ka rezultuar se kanë shkelur të drejtat e transmetimit.

Gjatë vitit 2012, janë vendosur 116 sanksione gjobë. Më konkretisht, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka vendosur 66 sanksione me gjobë, (20 nga të cilat, të vendosura në fund të vitit 2012, janë në proces shqyrtimi për vitin 2013) si dhe 33 sanksione paralajmërimi, **vetëm për mosrespektimin e të drejtave të transmetimit**. Përveç sanksioneve të vendosura për pirateri, janë vendosur edhe 17 sanksione për kundërvajtje të tjera administrative të parashikuara në ligjin organik. (Bashkëlidhur raportit, **në Aneksin 1**, pasqyrohen të gjithë sanksionet e vendosura ndaj subjekteve gjatë vitit 2012).

KKRT-ja, në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2010-2015, ka rritur bashkëpunimin me të gjitha institucionet e përfshira në mbrojtjen e pronësisë intelektuale. Lidhur me të drejtat e transmetimit, KKRT ka intensifikuar bashkëpunimin me ZSHDA, si institucioni kryesor i cili monitoron dhe kontrollon respektimin e të drejtave të autorit, si dhe me Agjencitë e Administrimit Kolektiv.

Një numër i konsiderueshëm problemesh, që kanë të bëjnë me të drejtat e transmetimit dhe të autorit pritet të gjejnë zgjidhje me miratimin e ligjit të ri “Për transmetimet audiovizuale në Republikën e Shqipërisë”. KKRT-ja ka dhënë kontributin e saj gjatë hartimit të projektligjit, për të gjitha çështjet, ndër të tjera edhe për çështjen e të drejtave të autorit.



3 PROGRAMACIONI

3.1. MBI PËRMBAJTJEN DHE ETIKËN E PROGRAMEVE

Edhe për vitin 2012, një nga drejtimet kryesore të punës së KKRT-së ka qenë kontrolli i përmbajtjes së programeve të ndryshme radiotelevizive: programeve informative, kulturore, programeve për fëmijë e të rinj, duke u përqendruar te realizimi i funksionit edukues, kulturor, argëtues e etik të tyre. Realizimi i këtij synimi është bërë në dy kahje të ndryshme: përmes mbikëqyrjes, vizionimit e monitorimit të përmbajtjes së programeve më të ndjekura në televizionet kombëtare dhe në disa televizione vendore, si dhe përmes ballafaqimit e krahasimit të strukturave programore të licencuara me transmetimet aktuale të operatorëve radiotelevizivë.

Në këtë proces është mbajtur gjithnjë parasysh parimi i rëndësishëm se veprimtaria televizive është e lirë dhe operatorët radiotelevizivë në tregun mediatik janë krejt të pavarur. Mbikëqyrja, nga Drejtoria e Programeve, e zbatimit të ligjit dhe rregulloreve të KKRT-së nuk ka të bëjë me censurën ose me ndonjë ndikim sado të vogël në pavarësinë e paanësinë e përmbajtjes së programeve të cilitdo operatori radioteleviziv. Ndjekja, vizionimi e monitorimi i programeve ka të bëjë me zbatimin e kërkesave të legjislacionit për median, me respektimin e drejtave të transmetimit, të drejtat e autorit, kontratave, ruajtja e raporteve mes programeve shqip - gjuhë e huaj, por sidomos me respektimin e vlerave, normave e kërkesave etike e morale në përmbajtjen e programeve. Këtij objektivi i ka shërbyer zbatimi i politikave dhe strategjisë së KKRT-së në njohjen e vlerësimit në vijimësi të strukturave programore të operatorëve radiotelevizivë, sidomos atyre kombëtarë, komunikimi i vazhdueshëm me operatorët radiotelevizivë dhe organizma të tjerë të fushës, si dhe sensibilizimi i opinionit publik. Qëllimi i përhershëm dhe i përbashkët i këtij komunikimi mbetet zbatimi i legjislacionit në fuqi, përpjekja për të plotësuar e përmirësuar hapësirat ligjore si dhe ndërgjegjësimi gjithnjë e më i lartë i operatorëve për misionin, rolin dhe ndikimin e transmetimeve të tyre në zhvillimet e sotme të shoqërisë shqiptare.

Për vitin raportues, vihet re se ka një rritje të ndjenjës së përgjegjësisë së operatorëve radiotelevizivë jo vetëm ndaj llojshmërisë e larmisë së programeve, por edhe ndaj cilësisë së përmbajtjes së tyre. Besojmë se kjo është pasojë e konkurrencës në rritje, që kërkon gjithnjë e më shumë cilësi për mbijetesë në një treg të ashpër, është rrjedhojë e aplikimit të teknologjisë më të re me ndikim të drejtpërdrejtë; por është gjithashtu edhe pasojë e ndërgjegjësimit për domosdoshmërinë e zbatimit të ligjshmërisë, e kërkesës për respektim të standardeve profesionale, gjuhësore dhe etike. Kjo nuk do të thotë se në fushën e përmbajtjes nuk ka probleme, se nuk ka shkelje të ligjit e mosrespektim të Kodeve Etike, shkelje të cilat kanë qenë objekt i punës dhe trajtimit me përparësi nga Drejtoria e Programeve, duke u bërë më pas objekt i punës së Këshillit të Ankesave dhe KKRT-së.

Objekt i vëzhgimeve, sondazheve të pjesshme, vizionimeve e monitorimeve tona njëvjeçare kanë qenë kryesisht programet informative, programet informative argëtuese,

programet kulturore argëtuese, si dhe programet për fëmijë të transmetuara nga operatorë të ndryshëm. Këto lloj programesh janë ndjekur me përparësi, jo si qëllim në vetvete, por për shkak të impaktit e ndikimit që kanë në publik, si dhe për vetë ndjeshmërinë e publikut ndaj tyre. Pikërisht në këtë drejtim janë vënë re edhe ato çështje ku jemi ndalur, edhe për faktin se një pjesë e madhe e ankesave e problemeve që ngrenë teleshikuesit, drejtpërdrejt në ankesa ose në forma të tjera lidhen me këto lloj programesh. Problematika e tyre, edhe pse e ndryshme mund të grupohet në:

- a) Çështje që lidhen me shkelje të dinjitetit vetjak, të mosrespektimit të privatësisë e të personalitetit të individit në programe televizive. Për çështje të kësaj natyre, KKRT-ja është mbështetur në legjislacionin shqiptar, por edhe në Konventën Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”, sipas së cilës *“çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes...”* por *“Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike [...] për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve...”* Mbrojtja e dinjitetit vetjak dhe respektimi i personalitetit të individit në programe televizive përfshin gjithë aktorët në komunikim dhe ndjeshmëria e opinionit publik ndaj tyre është e lartë. Përveç televizioneve vendore, në ndonjë rast, KKRT-ja është ndalur edhe lidhur me programe të ndryshme të televizioneve kombëtare si “Voice of Albania” (Televizioni Top Channel), apo “X Factor” (Televizioni “Klan”) si dhe në programe të veçanta për fëmijë. Për programe të këtij lloji Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka bashkëpunuar edhe me organizma si Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Avokati i Popullit. KKRT-ja është përpjekur që raste të tilla t’i shqyrtojë me paanësi, mbështetur në dispozitat ligjore, në përcaktimet e Kodit të Etikës dhe në kriteret profesionale duke marrë masat përkatëse, përgjithësisht tërheqje vëmendjeje, ndaj subjekteve transmetues. Për masa më ekstreme mund të përmendim, sa për ilustrim, ndalimin, me një shkresë të posaçme të KKRT-së për të gjithë operatorët radio-televizivë, e reklamës “Internet 3G”, e cila përmbante imazhe të dhunshme, si dhe ndërprerjen e transmetimit të videoklipit të këngës “High”, të grupit Baba Stars, ku shfaqeshin pamje të fushave të mbjella me *canabis sativa*.
- b) Çështje që lidhen me mosrespektimin e normave morale dhe etike në programet radiotelevizive, me keqpërdorim të gjuhës e të fjalorit, me ndikim të drejtpërdrejtë në formimin e ruajtjen e shëndetit moral e mendor të fëmijëve. Nga numri i ankesave që vijnë në KKRT, nga debatet e vetë mediave të ndryshme për etikën televizive, sot mund të themi se është rritur ndjeshëm shqetësimi i publikut ndaj etikës së produktit mediatik që futet në shtëpitë e tyre përmes ekranit apo kompjuterit. Duhet theksuar se trajtimi i problemeve etiko-morale lidhet, veç të tjerash, edhe me standardet e nivelin profesional të gazetarëve e drejtuesve të operatorëve radiotelevizivë. Mosrespektimi i etikës së komunikimit televiziv vërehet sidomos në programet televizive të përgatitura nga vetë subjektet, si janë rastet e show-ve humoristike dhe të programeve *reality*, të drejtpërdrejtë ose në ritransmetim, veçanërisht lidhur me gjuhën e përdorur. Për këto çështje

projektligji i ri për median elektronike parashikon që krahas Këshillit të Ankesave pranë KKRT-së, të funksionojnë edhe këshillat e ankesave ose bordet e etikës pranë çdo subjekti radioteleviziv. Madje këto borde të përgatisin edhe kodet e etikës së institucioneve të tyre, të cilat mendohet të jenë një nga kushtet e licencimit apo të rilicencimit. Lidhur me etikën e programeve televizive, vijnë të shfaqen edhe problematikat më të mprehta e më të diskutueshme, sidomos në programet argëtuese: informative, spektakle humoristike, variete televizive. Nga KKRT-ja janë vizionuar në mënyrë të herëpashershme, gjatë gjithë vitit, programe emisione e spektakle si “Zonë e lire” (rreth 28 emisione), “Aldo Morning Show” (18 emisione), “Portokalli” (12 spektakle), “Fiks fare” (rreth 24 emisione), “By pass Show” (10), “Apartamenti 2XL” (9), programet humoristike të televizionit “Tirana TV” (8) dhe programet për fëmijë të televizioneve të Tiranës (kombëtare dhe vendore). Rezultat i drejtpërdrejtë i këtij vizionimi është një bashkëpunim efikas dhe i frytshëm i KKRT-së me Këshillin e Ankesave. Mbështetur në ligjin aktual u bë ripërtëritja e institucionit të Këshillit të Ankesave pranë KKRT-së, me synimin që ky organizëm këshillimor t’u përgjigjej shqetësimeve të qytetarëve, lidhur me respektimin nga ana e subjekteve radiotelevizive, publike dhe private, të normave etike dhe morale. Informacionet dhe relacionet e përgatitura për këto probleme kanë shërbyer për komunikim të vazhdueshëm institucional të KKRT-së me operatorët realizues dhe transmetues të këtyre programeve, përmes shkresave për ndalim transmetimi, kujtesave e tërheqjes së vëmendjes (në ndonjë rast edhe në mënyrë të përsëritur) për shkelje të etikës së komunikimit, mosrespektim të dinjitetit e të drejtave të të miturve, përdorimit të fjalorit të papërshtatshëm për ekranin etj.

Raste si ai i televizionit “Tirana TV”, ku KKRT-ja u ndal pikërisht se shkelen të drejtat e fëmijëve nuk duhet të përsëriten nga asnjë operator televiziv. Normat etike ndryshojnë nga një kohë në tjetrën, nga një vend në tjetrin, por respektimi i etikës dhe kujdesi për shëndetin mendor e psikik të fëmijëve e të moshave të reja ka qenë dhe mbetet prioritar, në çdo kohë e për çdo vend.

Këto problematika u trajtuan edhe në seminarin mbi çështjet e etikës në media, organizuar nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Etikës në Media, (21 shtator 2012) në bashkëpunim me CIME (Qendra Ndërkombëtare për Etikën në Media). Në seminar morën pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore, përfaqësues të medias elektronike dhe asaj të shkruar që operon në vend, si dhe përfaqësues të shoqatave të gazetarëve. Megjithatë, jo të gjitha televizionet private kombëtare ishin të pranishëm në këtë seminar. 21 shtatori është një ditë kur diskutohet dhe debatohet për problemet e etikës në media në të gjitha vendet me media të pavarur, të lirë dhe profesionale, prandaj KKRT-ja do ta shfrytëzojë këtë ditë edhe në vijim për të sensibilizuar respektimin e normave etike e morale.

Nga ana tjetër, nuk mund të mos përmendim rishtas një dukuri të përsëritur që vijon të vihet re në programacionin e operatorëve radiotelevizivë: varfëria dhe uniformiteti në programet e pakta për fëmijë. KKRT-ja, edhe në raportin e vitit të kaluar e nënvizoi këtë problem, edhe pse nuk përbën një shkelje të drejtpërdrejtë ligjore dhe në thelb është çështje e vizionit të çdo operatori radioteleviziv për cilësinë dhe përgjegjësinë qytetare

ndaj teleshikuesve të vet. Me gjithë përmirësimin e disa programeve për fëmijë, zhvillimet e sotme mediatike, aftësia dhe fuqia teknologjike e profesionale e televizioneve duhet të harmonizohet me kërkesat gjithnjë në rritje të teleshikuesve të mitur e të rinj. Vërehen përpjekje të ndonjë operator i veçantë, por jemi ende në fazën që dëshmon se përvoja më e mirë në këtë drejtim mbetet ajo e spektakleve e konkurseve muzikore për fëmijë si dhe filmat e huaj të animuar.

Gjithashtu i është kushtuar vëmendja e duhur edhe respektimit të gjuhës standarde nga ana e operatorëve televizivë, sidomos ata që transmetojnë informacione me titra. Në transmetimet e operatorëve kombëtare vihet re një përmirësim i ndjeshëm, një kujdes në rritje ndaj shqipes së shkruar në ekran. Problemet më të mëdha në mosrespektimin e normës së drejtshkrimit e drejtshqiptimit vihen re në televizionet vendore.

3.2 DUKURI TË PROGRAMEVE INFORMATIVE

Gjatë vitit 2012 është realizuar monitorimi i edicioneve informative të transmetuara nga operatorët radiotelevizivë kombëtare në përputhje me kërkesat ligjore të nenit 7, pika 2, të Ligjit Nr. 8410, datë 30.09.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Të dhënat e monitorimit mujor të këtyre operatorëve u janë dërguar institucionit të Presidentit, Kryeministrit, Kryetares së Kuvendit, Këshillit të Ministrave, Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe janë bërë publike për të gjithë subjektet e interesuara përmes afishimit të rezultateve të monitorimit në faqen zyrtare të KKRT-së.

Në këto të dhëna është monitoruar koha e vënë në dispozicion nga operatorët radiotelevizive në edicionet informative, për veprimtaritë e partive politike, institucioneve shtetërore dhe të pavarura, aktorët e ndryshëm politike, veprimtaritë social-ekonomike, etj. Po ashtu pasqyrohen të dhëna të hollësishme mbi prezencën sinkron të personaliteteve politike dhe shtetërore. Gjatë monitorimit janë përcaktuar edhe të dhëna lidhur me vendin që kanë zënë në edicionet e lajmeve tema të tilla si politika, lajmet ndërkombëtare, ekonomia, veprimtaritë e Parlamentit, të qeverisë, arsimit, arti dhe kultura, kronika e zezë, shëndetësia, kriminaliteti, biznesi, sporti, etj.

Në edicionet informative kryesore të lajmeve të transmetuara nga operatorët radiotelevizivë i jepet rol parësor informacioneve mbi politikën. Lajmet kryesore të edicionit informativ janë ato që flasin për veprimtarinë e Presidentit, Qeverisë dhe të Kryeministrit, partive politike, e në vazhdim ato me përmbajtje ekonomike dhe social-kulturore.

Në vijim po ju paraqesim një përmbledhje të të dhënave statistikore të monitorimit të edicioneve informative për vitin 2012. Në përmbledhje janë pasqyruar raportet kohore në përqindje të kohës së plotë dhe sinkron të subjekteve politike dhe institucioneve qendrore, koha për temën e lajmit si dhe të aktorit sinkron.

- Raportet kohore për pasqyrimin e veprimtarisë së subjekteve politike dhe institucioneve nga radiot dhe televizionet;
- Raportet kohore për pasqyrimin e veprimtarisë së subjekteve politike dhe institucioneve nga radiot dhe televizionet

RAPORTET KOHORE PËR SUBJEKTET POLITIKE DHE INSTITUCIONET

Koha e plotë, viti 2012

Koha e Plotë për Subjektet Politike dhe Institucionet Qendrore (koha në përqindje)					
Viti 2012					
Subjektet/Operatori	Top Channel	TV Klan	TVSH	Radio Tirana	Top Albania Radio
Presidenti	4.59	3.37	3.74	3.56	4.29
Kryeministri	15.53	33.50	36.50	32.38	16.66
Qeveria	9.21	20.29	25.98	25.50	10.73
Parlamenti	9.09	9.42	9.28	11.47	7.88
Partia Demokratike	7.35	13.07	12.64	9.98	7.88
Partia Socialiste e Shqipërisë	42.56	11.67	6.84	11.37	37.32
Lëvizja Socialiste për Integrim	3.58	4.42	2.87	3.91	4.15
Partia Republikane	0.50	0.44	0.42	0.37	0.90
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	0.53	0.39	0.07	0.05	0.48
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0.82	1.01	0.70	0.51	1.32
Aleanca Demokratike	0.00	0.02	0.13	0.06	0.03
Lëvizja Demokristiane	0.00	0.00	0.00	0.00	0.01
Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0.00	0.12	0.00	0.00	0.00
Partia Agrare Ambientaliste	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Bashkimi Liberal Demokrat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Demokracia Sociale e Shqipërisë	0.57	0.69	0.11	0.28	1.14
Partia Demokristiane	0.06	0.38	0.01	0.01	0.02
Partia e Ballit Kombëtar	0.00	0.01	0.02	0.00	0.00
Partia e Ballit Kombëtar Demokrat	0.00	0.00	0.11	0.00	0.00
Partia G99	0.01	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Lëvizja e Legalitetit	0.10	0.17	0.18	0.10	0.15
Partia për Ligj dhe Drejtësi	0.11	0.07	0.00	0.02	0.16
Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	0.72	0.33	0.04	0.05	0.40
Partia Socialiste 91	0.08	0.02	0.01	0.01	0.08
Partia Komuniste e Shqipërisë	0.00	0.08	0.00	0.00	0.00
Partia Pensioniste	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Aleanca Kuq e Zi	2.56	0.05	0.00	0.00	4.03
Partia Fryma e Re Demokratike	1.62	0.05	0.00	0.00	1.86
Partia Aleanca Demokristiane	0.03	0.00	0.04	0.00	0.00
Partia Lidhja për Drejtësi dhe Progres	0.01	0.09	0.05	0.00	0.04
Shuma	100.00	100.00	100.00	100.00	100.0

RAPORTET KOHORE PËR SUBJEKTET POLITIKE DHE INSTITUCIONET
Koha sinkron viti 2012

Koha Sinkron për Subjektet Politike dhe Institucionet Qendrore (koha në përqindje)					
Viti 2012					
Subjektet/Operatori	Top Channel	TV Klan	TVSH	Radio Tirana	Top Albania Radio
Presidenti	3.58	2.07	1.97	2.78	3.22
Kryeministri	14.54	33.57	37.50	34.31	17.17
Qeveria	9.64	21.19	22.80	22.15	11.10
Parlamenti	1.75	5.27	5.12	5.22	2.50
Partia Demokratike	9.44	17.45	18.45	13.82	9.76
Partia Socialiste e Shqipërisë	48.48	10.76	9.04	14.64	41.95
Lëvizja Socialiste për Integrim	4.33	5.29	3.10	4.81	4.40
Partia Republikane	0.52	0.52	0.38	0.53	0.57
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	0.52	0.41	0.07	0.09	0.51
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0.66	0.88	0.66	0.48	1.05
Aleanca Demokratike	0.00	0.04	0.20	0.00	0.00
Lëvizja Demokristiane	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0.00	0.10	0.00	0.00	0.00
Partia Agrare Ambientaliste	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Bashkimi Liberal Demokrat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Demokracia Sociale e Shqipërisë	0.74	0.76	0.11	0.38	1.33
Partia Demokristiane	0.09	0.56	0.01	0.00	0.03
Partia e Ballit Kombëtar	0.00	0.01	0.03	0.03	0.00
Partia e Ballit Kombëtar Demokrat	0.00	0.00	0.11	0.00	0.00
Partia G99	0.01	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Lëvizja e Legalitetit	0.05	0.18	0.16	0.11	0.16
Partia për Ligj dhe Drejtësi	0.16	0.07	0.00	0.04	0.18
Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	1.01	0.44	0.05	0.08	0.49
Partia Socialiste 91	0.10	0.02	0.01	0.00	0.11
Partia Komuniste e Shqipërisë	0.00	0.10	0.00	0.00	0.00
Partia Pensioniste	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Aleanca Kuq e Zi	2.42	0.05	0.00	0.00	2.87

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT



Partia Fryma e Re Demokratike	1.77	0.02	0.00	0.00	1.85
Partia Aleanca Demokristiane	0.03	0.00	0.06	0.00	0.00
Partia Lidhja për Drejtësi dhe Progres	0.01	0.04	0.04	0.00	0.04
Shuma	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00




- Raportet kohore për temën e lajmit

Koha e Plotë për Temën e Lajmit (koha në përqindje)					
Viti 2012					
Temat	Top Channel	TV Klan	TVSH	Radio Tirana	Top Albania Radio
1.Politikë	25.21	18.35	13.10	14.42	26.05
2.Veprimtaria e Presidentit	1.23	0.92	1.51	2.21	1.36
3.Veprimtari e Qeverisë	5.71	12.06	18.69	19.38	6.84
4.Veprimtari e Parlamentit	5.84	5.66	7.58	8.51	7.60
5.Veprimtari e Qeverisë Vendore	1.54	2.88	3.13	4.06	1.47
6.Veprimtaria e Drejtësisë	4.72	2.38	0.83	1.53	3.01
7.Sociale	12.75	14.56	21.59	9.34	8.50
8.Ekonomi	4.76	7.20	5.75	3.71	3.37
9.Kronika e Zezë / Rendi	3.36	5.78	1.18	3.39	6.30
10.Lajme nga Kosova / Rajoni	9.90	3.16	2.31	9.20	12.26
11.Lajme Ndërkombëtare	12.11	9.54	4.10	8.35	9.20
12.Art / Kulturë / Kuriozitete	4.83	4.84	8.49	3.31	1.63
13.Sport	3.12	5.82	5.66	7.53	4.52
14.Të tjera	4.91	6.83	6.08	5.08	7.89
Shuma	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00

Në tabelën e mësipërme vërehet se në edicionet informative kryesore të lajmeve të transmetuara nga operatorët radiotelevizivë gjatë vitit 2012 i kanë kushtuar më tepër kohë temës së politikës.

Grafiku i mëposhtëm pasqyron qëndrimin e operatorëve Top Channel, Klan, TVSH, dhe Radio Tirana e Top Albania Radio ndaj temave ekonomike, sociale kulturore, të artit, sportit, krahasuar kjo me kohën kushtuar temës së politikës.





- Raportet kohore për aktorët “Sinkron”

Koha Sinkron për Aktorët Politikë (koha në përqindje)					
Viti 2012					

AKTORI SINKRON	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL	RADIO TIRANA	TOP ALBANIA RADIO
Bujar Nishani	2.29	2.90	1.98	2.87	2.18
Sali BERISHA	46.48	40.67	18.26	38.35	21.25
Jozefina TOPALLI	5.08	5.04	1.73	5.54	2.54
Edi RAMA	3.78	5.44	17.56	6.88	15.26
Ilir META	2.24	3.65	3.47	3.29	3.19
TË TJERË	-	-	-	-	-

3.3 LIGJSHMËRIA NË TRANSMETIMIN E REKLAMAVE

Një nga drejtimet më të rëndësishme të punës së KKRT-së, gjatë vitit 2012, ka qenë monitorimi në vazhdimësi i zbatimit të kërkesave ligjore për transmetimin e reklamave nga operatorët radiotelevizivë. Përparësi kryesore i është dhënë monitorimit të operatorëve kombëtarë, TVSH, TV Klan, Top Channel, Vizion Plus, Albanian Screen, Radio Tirana, Top Albania Radio, si dhe televizioneve News 24, Abc, A1 Report, UTV, Planet, Tv Shijak, Channel One, Ora News, Koha. Monitorime të herëpashershme, përmes materialeve të marra nga grupet e inspektimit të KKRT-së, janë kryer edhe për transmetimin e reklamave në televizione vendore në rrethe të ndryshme të vendit.


Nga ky monitorim ka rezultuar se, në përgjithësi, janë bërë përpjekje për zbatimin e kërkesave ligjore për transmetimin e reklamave. Në këtë drejtim mbeten ende problematike, rastet e shkeljeve të detyrimeve ligjore në transmetimet e reklamave në gjuhë të huaj. Respektimi i ligjit i detyron operatorët radiotelevizivë të transmetojnë reklamat me folës në shqip ose me subtitrimë shqip. Në respektimin e kësaj kërkesë ligjore janë verifikuar shkelje nga të cilat mund të përmendim rastet e televizioneve Tv-Klan, Top Channel, Ora News, Shijaku, Scan, dhe Planet. Problematike mbeten ende edhe reklamat e tërthorta në programe të tjera, të bëra nëpërmjet referimeve të qarta të emrit, markës dhe vendit dhe në raste të veçanta të shoqëruara edhe me pamje vizive.

Këto lloj reklamash janë vërejtur më shumë në programe si “ “Zonë e lirë” dhe “E diela shqiptare”. Një pjesë më e vogël e shkeljeve është vërejtur në kushtet e paraqitjes së reklamave dhe në detyrimin për të qenë të ndershme, duke mos paragjykuar të tjerët. Gjithashtu, nga monitorimi i programit ditor të operatorëve radiotelevizivë, për respektimin e afatit kohor të transmetimit të reklamave, (i cili nuk duhet të kalojë 15% të kohës së përgjithshme të transmetimit dhe 12 minuta për një orë transmetimi), është konstatuar se këto kërkesa janë respektuar, përgjithësisht, në mënyrë korrekte.


Gjatë këtij viti, në zbatim të kërkesës ligjore për ruajtjen e reklamave të transmetuara, të regjistruara për një kohë 1-vjeçare nga dita e transmetimit, janë ndërmarrë një seri kontrollesh ndaj operatorëve radiotelevizivë vendorë. Nga këto kontrolle është konstatuar se kjo dispozitë e ligjit është respektuar nga shumica e transmetuesve. Në rastet kur janë konstatuar mangësi në ruajtjen e reklamave brenda afateve të përcaktuara me ligj, janë marrë masa ndaj subjekteve përkatëse. Konkretisht janë kontrolluar 20 televizione vendore dhe për njërin prej tyre (TV-Fokus) është marrë masë ndëshkim me gjobë nga KKRT-ja.

Problemet që kanë dalë gjatë monitorimit të reklamave po i paraqesim në grafikët që vijojnë:

- Grafiku i shkeljeve të ligjit për reklamat për të cilat janë marrë masa.



- Raporti i shkeljeve të ligjit për reklamat sipas verifikimit të subjekteve të monitoruara.



3.4 MBI REGJISTRIMIN DHE MONITORIMIN E PROGRAMEVE

Në terma statistikorë, për vitin 2012, në Studion e Monitorimit, në KKRT, janë regjistruar në total **rreth 80 000 orë transmetimi** televizive (16 orë/ditë x 30 ditë x 12 muaj x 14 kompjuterë) dhe rreth **1500 orë transmetimi** radiofonike. Gjithashtu, gjatë këtij viti, janë monitoruar afro **1800 edicione** informative (5 edicione/ditë x 30 ditë x 12 muaj). Për regjistrimin e televizioneve që shihen në qytetin e Tiranës janë në funksion 15 kompjuterë regjistruar që, sipas një plani mujor të përcaktuar, regjistrojnë nga ora 11⁰⁰ deri në 07⁰⁰ të ditës së nesërme, për t'u ristartuar përsëri në 11⁰⁰.

Duke qenë përbërëse e Drejtorisë së Programeve kjo Studio është e organizuar në dy seksione të veçanta brenda saj: në pjesën regjistruese të studios ku janë të vendosur pesëmbëdhjetë kompjuterë që regjistrojnë mesatarisht 16 orë në ditë dhe në pjesën monitoruese ku punojnë monitoruesit, të cilët në përputhje me një plan javor apo edhe mujor, bëjnë monitorimin e edicioneve qendrore të lajmeve të tre televizioneve kombëtare (TVSH, KLAN dhe TOP CHANNEL) si edhe të dy radiove kombëtare (RADIO TIRANA dhe TOP ALBANIA RADIO).


Informacioni i marrë nga monitorimi i lajmeve në Studio është një material i bollshëm dhe i larmishëm që përpunohet më tej nga Drejtoria e Programeve. Gjithashtu, pjesë e punës së përditshme të monitoruesve është edhe monitorimi i programeve të subjekteve televizivë, në lidhje me strukturën programore si dhe me respektimin e të drejtave të autorit. Regjistrimi i radiove në mënyrë të pandërprerë, gjatë këtij viti, ishte një përmirësim i rëndësishëm teknik, që ka rritur ndjeshëm rendimentin e punës së monitoruesve. Kjo krijon mundësinë që të monitorohen edhe subjektet e tjera radiofonike, që dëgjohen në rrethin e Tiranës, për problematika të ndryshme të përmbajtjes apo të të drejtave të autorit, të cilën e bënte shumë të vështirë teknologjia e vjetër e regjistrimit me magnetofona dhe kaseta audio.

Gjatë vitit 2012, kapaciteti ruajtës i Studios së Monitorimit është rritur me futjen në punë edhe të një serveri të ri, gjë që ka çuar në rritjen e aftësive të Studios për sa i përket ruajtjes së materialeve të regjistruara. Hapësira ruajtëse e serverave (3 server), tashmë është rreth 7900 GB së bashku, gjë që, në terma kohorë, ka rritur kohën e ruajtjes së informacionit në 3 muaj për televizionet kombëtare dhe 2 muaj për televizionet e tjerë lokalë. Gjithashtu, në këto kushte të rritjes së hapësirave ruajtëse, në serverët e Studios së Monitorimit, janë në ruajtje edhe edicionet e lajmeve të tre televizioneve kombëtare (Televizioni Publik Shqiptar, Televizioni Kombëtar Klan dhe Televizioni Kombëtar Top Channel) për një periudhë njëvjeçare. Janë në ruajtje edhe regjistrimet e kryera gjatë vitit 2012 në lidhje me respektimin e të drejtës së transmetimit dhe të të drejtës së autorit.

Gjatë gjithë vitit raportues është kryer në mënyrë të pandërprerë monitorimi i edicioneve kryesore të lajmeve për Televizionin Publik Shqiptar dhe dy televizionet kombëtare private: TV Klan dhe Top Channel, si dhe të 2 radiove kombëtare, Radio Tiranës dhe Top Albania Radios. Në këtë proces janë monitoruar programet e televizioneve kombëtare: TVSH, KLAN dhe TOP CHANNEL, si dhe të televizionit VIZION PLUS, dhe për periudha të caktuara televizioneve KOHA, CHANNEL ONE, ORA NEWS, UTV, AS, SHIJAK.

Janë monitoruar gjatë vitit 2012:

nr	Subjekti i monitoruar	Orë programesh të monitoruar
	TVSH	3200
	KLAN	3200
	TOP CHANNEL	3200
	VIZION PLUS	3200
	CHANNEL ONE	1800
	KOHA	400
	MUZYKORE ¹	400
	TV LOKALE	160



Gjate këtij viti ka pasur një rritje të materialeve që janë përpunuar në Studion e Monitorimit dhe është e rëndësishme që të vijojë puna e nisur për zgjerimin e hartës së televizioneve lokalë që monitorohen në Studio. Por, në kuadër të zbatimit të VKM-së “Për Miratimin e Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike”, Nr. 292, datë 2.5.2012, është e nevojshme që edhe Studioja e Monitorimit të përshtatet nga pikëpamja teknike për të përballuar këtë kalim.

Përfundimet dhe problematikat që kanë dalë nga monitorimet dhe përpunimet e të dhënave për edicionet informative apo përmbajtjen e programeve të ndryshme dëshmojnë për përpjekje të vijueshme të operatorëve radiotelevizivë për zbatimin e legjislacionit në fuqi. Nga ana tjetër, respektimi i parimeve themelore të veprimtarisë televizive, gara e vazhdueshme mes operatorëve dhe cilësia e përmbajtjes dhe e transmetimit kërkojnë përkujdesje më të madhe të transmetuesve ndaj deontologjisë së medias, pra, ndaj çështjeve të etikës së programeve televizive. Lidhur me këtë KKRT-ja ka bërë propozimet e plotësimet përkatëse për projektligjin e ri të medias elektronike dhe do të vijojë të ndjekë me vëmendje e përgjegjësi zhvillimet dhe dukuritë programore në transmetimet e operatorëve radiotelevizivë.

¹ Termi “muzikore” përfshin televizionet Klub FM, BBF, SUPERSONIC, dhe Tirana TV.

4. RRJETET E TRANSMETIMIT DHE MBULIMI ME SINJAL I ZONAVE TË LICENCIMIT

Gjatë vitit 2012, KKRT-ja ka vazhduar punën për konsolidimin e veprimtarisë teknike në fushat e **Planifikimit të spektrit të frekuencave, Monitorimit të shfrytëzimit** të këtij spektri dhe **Identifikimit të transmetimeve të paaautorizuara**. Një punë voluminoze është kryer për përpunimin e Strategjisë së kalimit në transmetimet numerike dhe mbylljen e transmetimeve televizive analoge.

4.1. PLANIFIKIMI I SPEKTRIT TË FREKUENCAVE

4.1.1. Planifikimi i rrjeteve televizive numerike

KKRT-ja ka vazhduar punën për sigurimin e implementimit të rrjeteve numerike, kombëtare, rajonale e vendore, mbështetur në frekuencat e planifikuara e të regjistruara tashmë në Regjistrin Ndërkombëtar të Frekuencave në ITU.

Siç është raportuar në Raportin për vitin 2009, në datën 20.08.2009 janë shkarkuar në WISFAT 354 caktime frekuencore, që përfaqësojnë të gjitha frekuencat UHF të parashikuara në Planin GE06 për Shqipërinë. Regjistrimi përbën një mbrojtje nga kontestimet e vendeve fqinjë.

Caktimet frekuencore numerike shqiptare, të regjistruara në sistemin WISFAT, janë pasqyruar në BRIFIC²- et e lëshuara periodikisht nga ITU, deri në datën 17.06.2012, që ishte data finale e caktuar nga ana jonë në formularët e njoftimit. Me kalimin e afatit të mësipërm, caktimet frekuencore numerike të Shqipërisë u fshinë nga baza e të dhënave të ITU-së (pa i hequr të drejtën Shqipërisë të shfrytëzonte kapacitetet sipas marrëveshjes GE-06, pasi në plan vazhdonin të figuronin allotmentet e planifikuara).

Fshirja e caktimeve të regjistruara është bërë për t'i hapur rrugë procedurës së **notifikimit të caktimeve frekuencore** për futjen në përdorim të caktimeve frekuencore (Notification of frequency assignments) në përputhje me pikën 5.1.1 të akteve finale të GE-06 që përcakton:

² The BR International Frequency Information Circular (BR IFIC) Terrestrial Services është një publikim rregullator, i lëshuar çdo dy javë nga Byroja e Radiokomunikacioneve (Radiocommunication Bureau), sipas Radio Rregulloreve (Radio Regulations) nr. 20.1 deri te 20.6 dhe nr. 20.15 si dhe disa Marrëveshjeve Rajonale. Ai përmban informacion mbi caktimet/allotmentet frekuencore, të paraqitura nga Administratat në Byronë e Radiokomunikacioneve për regjistrimin në Master Regjistrin e Frekuencave Ndërkombëtare (Master International Frequency Register) dhe në Plane/marrëveshje rajonale apo ndërbotërore. Informacioni i publikuar i korrespondon caktimeve/allotmenteve, si dhe të gjitha notifikimeve në proces. Format i DVD-ROM u jep përdoruesve mundësinë e konsultimit të BR IFIC-ut direkt nga DVD-ROM, pa instaluar të dhënat (rreth 4 Gbytes) në hard disk.

Kur një administratë propozon të sjellë në përdorim një caktim për një stacion transmetimi, ajo duhet të njoftojë (notifikojë) Byronë³, në përputhje me dispozitat e nenit 11 të Radio Rregulloreve⁴, karakteristikat e këtij caktimi, siç specifikohen në Aneksin 3 të Marrëveshjes⁵.

Këto njoftime, sipas ligjit “Për transmetimet Numerike” akoma në fuqi, duhej të ishin bërë brenda vitit 2012.

Për shkak të vonesave të njohura në miratimin e strategjisë së kalimit të plotë në transmetimet numerike si dhe të ligjit “Për transmetimet audiovizive”, gjatë vitit 2012 nuk u bë e mundur licencimi i rrjeteve numerike (kombëtarë, rajonalë dhe lokalë). Këto vonesa bënë të pamundur dërgimin e notifikimeve (njëra nga të dhënat që duhej dërguar për regjistrim ishte edhe emri i stacionit, që nuk mund të regjistrohej pa u bërë licencimi në përputhje me nenin 11 të RR⁶).

Në këto kushte, për t’i paraprirë procesit të digjitalizimit, në mënyrë që të shmangeshin vonesat në kryerjen e notifikimit, në bashkëpunim edhe me Byronë e Radiokomunikacioneve të ITU, duke përdorur një program të ITU, u krye konvertimi i njoftimeve (notice) të kryera në vitin 2009, në njoftime GT1 (GT1 notices), duke u lënë pa u plotësuar vetëm emri i stacionit, që do të njoftohet me t’u kryer procesi i licencimit. Këto njoftime, tashmë në formatin e duhur, u regjistruan në sistemin WISFAT gjatë muajit nëntor 2012. Viti i skadimit të këtyre caktimeve frekuencore tashmë është viti 2024, që siguron mbrojtje të mjaftueshme të caktimeve frekuencore shqiptare.

Në vitin në vazhdim, KKRT-ja do të punojë për të siguruar koordinimin me vendet e tjera, sidomos me vendeve që janë shënuar në një kolonë të veçantë (Kolona R-1⁷) në Planin e Frekuencave të GE-06.

4.1.2 Koordinimi me Italinë

Në ndjekje të detyrave të lëna nga viti i kaluar për koordinimin e frekuencave (sidomos atyre për transmetime televizive numerike tokësore) me Italinë⁸ në muajin prill 2012, në Romë, u organizua takimi dypalësh Itali-Shqipëri.

Nga pala italiane në takim morën pjesë përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit të Departamentit të Komunikacioneve të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Italisë dhe të Fondacionit “Ugo Bordonì”. Nga pala shqiptare në takim morën pjesë përfaqësues të Ministrit të Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dhe përfaqësues të KKRT-së.

³ Byroja - Byroja e Radiokomunikacioneve e Bashkimit ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU)

⁴ Radio rregulloret – rregulloret e ITU sipas neni 31 të Kushtetutës së ITU.

⁵ Marrëveshja - Marrëveshja GE-06

⁶ RR-Radio Rregulloret e ITU

⁷ Në Kolonën R-1 jepen simbolet e ITU për administratat, të cilave u preken caktimet analoge me futjen në punë të caktimit numerik.

⁸ Shih Raportin vjetor të KKRT-së, 2011

Në takim u konstatua se:

Italia ka firmosur Marrëveshjen GE06, por ende nuk e ka ratifikuar atë. Sidoqoftë, licencat e lëshuara për TV digjitale në Itali përfshijnë një deklaratë lidhur me nevojën për të respektuar Marrëveshjen GE-06.

Elementi kyç për zgjidhjen e problemeve të interferencës në brezat e GE-06, konsiderohet ratifikimi i kësaj Marrëveshjeje nga Parlamenti italian. Pas ratifikimit problemet e interferencës do të zgjidhen me shpejtësi, pasi do të ekzistojë baza ligjore për ndjekjen e problemeve.

Nga pala shqiptare, në takim, u kërkua stabilizimi i linjave të komunikimit të përhershëm e të bashkëpunimit midis administratave për zgjidhjen e problemeve të interferencave të dëmshme dhe lehtësimin e kalimit në transmetimet numerike, si dhe u parashtrua mundësia për organizimin e komunikimit zyrtar midis strukturave sidomos për:

1. Angazhimin e administratave për përdorimin e stacioneve të veta në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve GE84 dhe GE06. Në rastet e interferencave duhen aplikuar dhe respektuar dispozitat kryesore të RR. Gjendja kur një administratë – firmëtare apo jo e një marrëveshjeje rajonale – ushtron të drejtat, por nuk respekton detyrimet, duhet të përjashtohet (konkluzion i mbledhjes së Gjenevës për interferencat e shkaktuara nga Italia);
2. Hartimin e procedurës së detajuar të zgjidhjes së rasteve të interferencave të dëmshme, bazuar në Radio Rregulloret dhe përcaktimet e marrëveshjeve (GE84, ST 61 dhe GE06. Kjo procedurë mund të përfshijë vendosjen e prioriteteve të rasteve për t'u zgjidhur, duke treguar periodicitetin dhe natyrën e matjeve, përgatitjen e raporteve progresive, p.sh. në bazë mujore, informacionin e kontaktit të personave/njësive të përfshira direkt në këto aktivitete. Kjo procedurë do të jetë komplementare e nenit 15 të RR (konkluzion i mbledhjes së Gjenevës për interferencat e shkaktuara nga Italia);

Përgjigjja italiane ishte se ne i kemi në dispozicion të gjitha pikat e kontaktit dhe mund të veprojmë me të marrë sinjalin për çfarëdo problemi, kështu që nuk shihet e nevojshme të hartohen marrëveshje me shkrim. Kjo është praktika italiane edhe me Francën e me Zvicrën.

4.1.2.1 Koordinimi i frekuencave

Nga pala shqiptare u theksua se përdorimi, nga pala italiane, i frekuencave, që në planin GE06 bëjnë pjesë në planin numerik shqiptar, është në kundërshtim me dispozitat e marrëveshjes GE06. Pala italiane insistoi se përdorimi i këtyre kanaleve nuk do të shkaktojë interferencë në stacionet numerike shqiptare për shkak të fuqisë së ulët të rrezatuar, lartësisë efektive të vogël dhe drejtimit të antenave marrëse. Nga ana tjetër, sipas palës italiane, operatorëve që do të përdorin këto frekuenca do t'u imponohen rregulla, standarde e sanksione për të mos tejkaluar nivelet e karakteristikat e lejuara të transmetimit, duke premtuar njëkohësisht reagim të shpejtë në rast konstatimi të interferencave.

Pala shqiptare mbajti shënim këtë kërkesë italiane, duke mos premtuar në asnjë rast pranimin e saj, sidomos në kushtet kur pala italiane nuk ishte në gjendje të ofronte informacion të nevojshëm për llogaritjen teorike të intensitetit të sinjalit të transmetuesve italianë, që mund të mbërrijnë në brigjet shqiptare në kushte të ndryshme atmosferike. Nga pala shqiptare u theksua se është e domosdoshme që një informacion i tillë të merret përpara se transmetuesit të vihen në punë, për të parandaluar dëmet që mund t'u shkaktohen operatorëve shqiptarë, si atyre ekzistues analogë, ashtu edhe operatorëve të ardhshëm numerikë.

Pala italiane theksoi se aktualisht nuk është në gjendje të japë informacionin e kërkuar, pasi pritet plani i hartuar nga AGCOM-i. Një informacion i tillë mund të sigurohej kur të sqarohet situata.

Nga të dy palët takimi u konsiderua si shumë i vlefshëm, me karakter informues, pa obligime për palët dhe u shpreh vullneti për një kooperim të ngushtë gjatë këtij procesi teknik. Në përfundim të takimit u ra dakord që palët të informojnë rregullisht njëra-tjetrën mbi progresin e procesit në të dy vendet.

Gjatë fundit të vitit 2012, pala shqiptare ka nisur monitorimin e spektrit në zonat bregdetare për të ndjekur nivelet e sinjaleve të ardhur nga Italia, sidomos të nivelit të sinjaleve numerike.

4.1.3 Koordinimi me Greqinë


Gjatë vitit 2012, nga Ministria Greke e Transporteve, nëpërmjet AKEP-it, në adresë të KKRT-së, u paraqit një ankesë për interferencë të fuqishme të shkaktuar nga sinjali i RTSH-së (nga pika Cardhak Kanali 32 UHF) në sinjalin e një transmetuesi lokal grek (Flash TV) në pikën Mavroboyno Kastoria. Pas verifikimeve të KKRT-së në Regjistrin Ndërkombëtar të Frekuencave, rezultoi se kjo frekuencë nuk bënte pjesë në planin grek të transmetimeve analoge, pra nuk ishte regjistruar dhe, për pasojë, pretendimi grek për interferencë ishte i pabazuar. Pas kontaktimit me palën greke, ata e tërhoqën pretendimin për interferencë nga pala shqiptare.

Gjatë fundit të vitit 2012, në kuadrin e koordinimit të frekuencave të Planit Numerik Shqiptar, janë planifikuar kontakte me palën greke për të marrë miratimin e saj për vënien në punë të caktimeve frekuencore numerike të rrjeteve numerikë shqiptare dhe për të dhënë miratimin e palës shqiptare për caktimet frekuencore numerike greke.

4.1.4 Shfrytëzimi i dividendit digjital për shërbime të tjera të telekomunikacioneve.

Dividendi numerik kompenson kërkesën në rritje për shërbimet me bandë të gjerë dhe hap një spektër të mjaftueshëm për aplikimet në këtë fushë.

Sipas vendimeve të Konferencave Botërore të Komunikacioneve të vitit 2007 (WRC-07) dhe të vitit 2012 (WRC -2012), përdorimi i spektrit 470-862 MHz, i destinuar deri tani për transmetime televizive (sipas Planit Kombëtar të Frekuencave) është ndryshuar duke caktuar një pjesë të tij (790-862) për transmetime me bandë të gjerë (shih figurën e mëposhtme):



Siç përmendet edhe në Raportin e vitit të kaluar, brezi i frekuencave 790 – 862 MHz (Kanalet 61-69 UHF), aktualisht nën administrimin e KKRT-së⁹, në territorin e Shqipërisë shfrytëzohet nga:

1. transmetime analoge ekzistuese (28 caktime frekuencore të Digitalbit dhe 1 i Albanian Screen),
2. transmetime digjitale ekzistuese (jashtë planit GE-06) (29 caktime frekuencore).
3. transmetime digjitale të planifikuara në Marrëveshjen GE-06 (17 caktime).

Figura e mëposhtme pasqyron gjendjen e okupimit të brezit 790-862 MHz, i quajtur brezi DD1.





Figura Gjendja e okupimit të brezit të DD1 në Shqipëri

⁹ Bazuar në ligjin nr 8410 datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” dhe Planin Kombëtar të Frekuencave, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr .479, datë 06.05.2009.

Bazuar në vendimet e Konferencave botërore të cituara më sipër, ky brez, në vitin 2015, duhet të jetë i pastruar nga çdo lloj transmetimi televiziv, për t'u vënë në dispozicion të AKEP-it, i cili do të kryejë administrimin e tij, për t'i hapur rrugë licencimit të operatorëve të telekomunikacioneve.

Pas vitit 2015, me mbylljen e transmetimeve analoge si dhe transmetimeve digjitale të palicencuara, gjendja duhet të jetë sipas figurës së mëposhtme:



Siç shihet nga kjo figurë, për të realizuar lirimin e brezit të DD1, mbetet transferimi i caktimeve frekuencore të planifikuara sipas GE-06 në frekuencat më poshtë se frekuenca 790 MHz. Nëse ky transferim nuk mund të realizohet, kapaciteti i planit shqiptar të frekuencave numerike do të reduktohet.

Tabela e mëposhtme e Planit kombëtar të frekuencave numerike demonstroi se nga lirimi i brezit të DD preken dy mbulime kombëtare.

Në këtë tabelë, me ngjyrë të kuqe janë shënuar kanalet e planit numerik shqiptar të miratuara me Marrëveshjen GE06, që nuk do të përdoren, pasi bëjnë pjesë në brezin e DD. Siç shihet, për të plotësuar 7 mbulimet në UHF, nevojitet të përcaktohen 2 kanale të reja në brezin deri në 790 MHz për allotmentin e Lezhës dhe 2 të tjerë për allotmentin e Vlorës. Për këtë qëllim, me palën italiane do të negociohet përdorimi i kanaleve që bëjnë pjesë në planin e tyre digjital. Përcaktimi i këtyre kanaleve të rinj kërkon shmangie nga normat e vendosura nga GE06, duke lehtësuar disa parametra (p.sh. nivelin trigger të sinjalit në kufijtë e allotmentit).

Arritja e marrëveshjes për këta kanale shtesë do të bëhet pas verifikimit të rezultateve të kalkulimit (nëpërmjet modifikimit të fuqisë (ERP-ve) të stacioneve dhe llogaritjeve me anë të software-it GE06Calc, për të verifikuar nivelin e interferencave).

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

Mbulimet	Allotment i Shkodër	Allotment i Kukës	Allotment i Dibrë	Allotment i Lezhë	Allotment i Tiranë	Allotment i Elbasan	Allotment i Fier	Allotment i Berat	Allotment i Korçë	Allotment i Gjirokastrë	Allotment i Vlorë
	Kanali TV	Kanali TV	Kanali TV	Kanali TV	Kanali TV	Kanali TV	Kanali TV	Kanali TV	Kanali TV	Kanali TV	Kanali TV
1. Rezervë	9	9	8	9	10	7	10	5	6	8	8
2. RTSH MUX 1	22	26	24	23	21	23	22	24	21	26	23
3. RTSH MUX 2	28	32	25	29	34	33	27	25	27	29	39
4. Op.priv kombëtar	34	36	30	33	39	40	28	30	28	35	43
5. Op.priv kombëtar	41	40	38	43	53	42	29	32	43	37	46
6. Op.priv kombëtar	45	42	54	46	57	46	31	36	45	38	57
7. Op priv Lokal	51	50	55	66	59	48	35	47	51	44	64
8. Rezervë (afektuarDD)	59	52	60	68	61	49	45	52	55	48	68
Mb. vendore		56	63			56	51	54	57	50	
Mb. vendore		65	69			58		61	59	53	
Mb. vendore						62		65	64	56	
Mb. vendore						68		66		58	
Mb. vendore										60	
Mb. vendore										63	
Mb. vendore										67	
Mb. vendore										69	

Prekja e planit të frekuencave numerike shqiptare sipas GE-06 nga lirimi i spektrit të DD

4.1.5 Planifikimi i bandës FM

4.1.5.1 Gjendja

Administrimi i frekuencave të bandës FM ka qenë përherë problem i vështirë, për arsye:

1. të transmetimeve që kanë ekzistuar përpara krijimit të KKRT-së dhe që përdornin frekuenca të caktuara pa u mbështetur në kritere teknike;
2. të moszbatimit të termave të Marrëveshjes së Gjenevës (GE-84) nga vendet fqinje.

Marrëveshja e Gjenevës (GE-84) është dokumenti ndërkombëtar që rregullon shfrytëzimin e frekuencave radio FM. Shqipëria ka marrë pjesë në hartimin e Planit të frekuencave radio FM, i cili është i regjistruar në Regjistrin Ndërkombëtar të Frekuencave të ITU-së.

Por, për arsyet e përmendura më sipër, shumica e caktimeve frekuencore të operatorëve radio FM nuk janë në përputhje me planin e regjistruar të frekuencave.

Përpyekjet e KKRT-së për të zbatuar këtë plan kanë dështuar sistematikisht, për shkak të gjendjes së parregulluar të shfrytëzimit të frekuencave FM në shtetet fqinje, sidomos të Italisë.

Qeveria italiane nuk e ka nënshkruar dhe as ratifikuar Marrëveshjen GE 84 (Për radio FM). Për pasojë, dhënia e frekuencave për transmetime radio FM në Itali bëhet jo në përputhje me ndonjë plan të miratuar bashkërisht apo të koordinuar me fqinjët. Për këtë arsye, shumë zona të Shqipërisë, sidomos zonat e ekspozuara bregdetare pësojnë interferenca të vazhdueshme nga stacionet transmetues FM italianë. Problematike është sidomos zona Fier – Lushnjë. Për shembull, Radio Lushnja ka raportuar se, në muajt e verës, vazhdimisht, konstatohen interferenca nga stacioni italian Radio Due.

Gjatë vitit 2012, probleme të ngjashme janë hasur edhe në zonat fqinje me Greqinë, sidomos në zonën e Sarandës.

Problemi është rënduar kohët e fundit nga plotësimi i kërkesave në rritje për licenca radio FM.

4.2 Rregullimi i spektrit FM

4.2.1 Riorganizimi i frekuencave të zonës së Tiranës

Gjatë vitit 2012, u punua me sukses për zbatimin e planit të rregullimit të përdorimit të frekuencave në zonën e Tiranës, në përputhje me konkluzionet e Raportit të vitit të kaluar¹⁰ për Riorganizimin e shfrytëzimit të spektrit të zonës së Tiranës, që bëri të mundur shmangien e interferencave, duke lejuar një shfrytëzim më efektiv të brezit të disponueshëm. Ky fakt bëri të mundur licencimin e një operatori të ri në zonën Tiranë – Durrës. Në aneksin 2 tabela 1 jepet gjendja e shfrytëzimit të frekuencave FM në zonën e Tiranës.

¹⁰ Shih Raportin Vjetor të KKRT-së, 2011.

Vënia në zbatim e planit të rregulluar për zonën Tiranë-Durrës bëri që të stabilizohen transmetimet e Radio “Nacional”, Radio “Klan”, Radio “Greta”, Radio “Durrësi” etj., që përmendeshin si problematike në raportin e vitit të kaluar.

Pavarësisht sa më sipër, në zonën Tiranë-Durrës vazhdojnë të transmetojnë, pa autorizimin e KKRT-së, dy subjekte radiofonikë vendorë: Radio “Stinët” dhe Radio “New Planet”. Për të zgjidhur këtë situatë, KKRT-ja po bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme Tatimore dhe Drejtorinë Tatimore Rajonale të Tiranës, për mbylljen e veprimtarisë së dy subjekteve të mësipërm.

4.2.2 Rregullimi i shfrytëzimit të spektrit FM në territorin e Republikës

Gjatë vitit 2012, bazuar në eksperiencën e rregullimit të shfrytëzimit të spektrit në zonën Tiranë-Durrës, Drejtoria Teknike ka punuar për të sistemuar shfrytëzimin e spektrit edhe në zonat e tjera të Shqipërisë, duke filluar nga zonat më problematike, si Ultësira Perëndimore, zona e Sarandës, zona pranë liqenit të Ohrit etj.

Nga studimi në programin ICS dhe monitorimi në terren është arritur evidentimi i gjendjes së shfrytëzimit të spektrit në të gjitha pikat kryesore transmetuese, që ndodhen në territorin e Shqipërisë (transmetimet e licencuara, të palicencuara dhe prezenca e sinjaleve të huaja), për ta krahasuar gjendjen me planin GE-84 dhe për të përcaktuar zonat e mundshme të mbulimit. Kjo punë paraqitet në aneksin 2 tabela 2 e mëposhtme. Në bazë të këtyre tabelave të përditësuara mund të organizohet një shfrytëzim më optimal i brezit të frekuencave FM (87.5 – 104 MHz).

4.3 Planifikimi i rrjeteve analoge

4.3.1 Puna për planifikimin e frekuencave analoge (radio e tv), për licencimin e operatorëve të rinj dhe përmirësimin e mbulimit të operatorëve analogë ekzistues.

Edhe për vitin 2012, KKRT-ja ka vazhduar studimin e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave si për TV dhe radio FM, për të optimizuar këtë shfrytëzim, duke përcaktuar frekuencat të lira për shpalljen e konkurrencës të kandidaturave, në përgjigje të kërkesave. Për këtë janë kryer llogaritjet për mbulimin e zonave të licencimit dhe për eliminimin e interferencave me sinjalet e tjera radio dhe televizive.

Nga studimi në Programin ICS dhe matjet në terren mbetet konstant konkluzioni se shfrytëzimi i spektrit në Shqipëri vazhdon të rëndohet, sidomos në zonat me interes të lartë banimi (Ultësira Perëndimore deri në Sarandë, zona e Korçës, etj.) ndërsa nuk ka interes për mbulimin e zonave të largëta (Peshkopi, Bajram Curri, Ersekë).

Gjatë vitit 2012, është përgatitur dokumentacioni teknik për 6 caktime frekuencore për transmetime televizive vendore private (1 licencë e re dhe 1 zgjerim) dhe 10 caktime frekuencore për transmetime vendore private radio FM (shih më poshtë tabelat 2, 3, 4).

Pas zbatimit të procedurave të garave, gjatë vitit 2012, është licencuar 1 operator i ri televiziv privat vendor: TV VELECIKU (Shkodër) (1 caktim frekuencor).

Gjithashtu janë licencuar 4 operatorë vendorë privatë radio, duke planifikuar gjithsej 4 caktime frekuencore, në pika të ndryshme transmetimi.

Pas zhvillimit të konkurrimit të kandidaturave për licencë për televizion analog në rrethin Kavajë, qytetin Fier dhe qytetin Vlorë, TV ADRIAMED fitoi të drejtën të zgjerojë zonën e licencimit edhe në këto dy qarqe. Për këtë, këtij subjekti i janë shtuar 6 caktime frekuencore për mbulimin me sinjal të zonës së licencimit.

Në tabelat e mëposhtme (Tab.1, Tab.2, Tab.3 dhe Tab.4) janë paraqitur operatorët e licencuar në vitin 2012 dhe gjendja e tyre faktike e transmetimit.

Nr	Emri	Pika e transmetimit	Data e licencimit	Afati i fundit i daljes në transmetim	Zona e licenci-mit	Gjendja reale e transmetuesit
1	TV Veleçiku	Tarabosh	26.03.2012	05.02.2013	Rrethi Shkodrës	Brenda afatit

Tab. 1. Operatorë të rinj të licencuar për TV vendorë

Nr	Emri	Pika e transmetimit	Data e licencimit	Afati i fundit i daljes në transmetim	Zona e licenci-mit	Gjendja reale e transmetuesit
1	Radio Motiv	Tarabosh	26.03.2012	07.11.2012	Rrethi Shkodër	Në transmetim
2	Radio Glob	Berat Qytet	24.09.2012	16.04.2013	Qyteti Berat	Brenda afatit
3	Radio Capital	Fushë Dajt	24.09.2012	16.04.2013	Rrethi Tiranë-Durrës	Brenda afatit
4	Radio CRI (me përsëritës a)	Fushë Dajt	28.12.2012	28.06.2013	Rrethi Tiranë-Durrës	Brenda afatit

Tab. 2 Operatorët radiofonikë të licencuar në vitin 2012

Nr	Emri	Pikat e Transmetimit ekzistuese	Data e vendimit për zgjerim zone	Pika e re e transmetimit	Zgjerimi i zonës së mbulimit	Gjendja reale e transmetuesve në pikat e reja
1	TV ADRIA MED (zgjerim)	Kodra e Marinës (Durrës)	26.03.2012	Kavajë, Ardenicë, Zvërnec, Treblovë, Llogora, Mile	Rrethi Kavajë, Q.Fier, Q.Vlorë.	Brenda afatit

Tab. 3 Operatorët televizivë që kanë zgjeruar zonën e licencimit në vitin 2012

Nr	Emri	Pikat e transm. ekzistuese	Data e vendimit për zgjerim zone	Pika e re e transmetimit	Zgjerimi i zonës së mbulimit	Gjendja reale e transmetuesve në pikat e reja
1	Radio Travel	Mali i Dajtit	26.03.2012	Ardenicë, Zvërnec, Treblovë, Tërbac, Llogora, Mile	Qarku Fier, Qarku Vlorë	Brenda afatit

Tab. 4 Operatorët radio që kanë zgjeruar zonën e licencimit në vitin 2012

Në vitin 2012 janë përgatitur edhe Aneksat e dokumentit të licencës për 16 operatorë radiotelevizive, nga të cilët: 4 operatorë radio vendore, 2 operatorë për zgjerim, 1 operator televiziv vendor dhe 9 televizione kabllorë, të licencuar gjatë vitit 2012.

Në këtë vit janë shqyrtuar gjithsej 58 dosje me dokumentacionin teknik të paraqitur nga subjektet, gjatë procesit të licencimit dhe rilicencimit.

4.4 MONITORIMI I SHFRYTËZIMIT TË SPEKTRIT TË FREKUENCAVE

Bazuar në eksperiencën e fituar në vite, edhe gjatë vitit 2012, KKRT ka vazhduar inspektimet mbi shfrytëzimin e spektrit të frekuencave, me qëllim verifikimin e cilësisë së transmetimeve, identifikimin e lokalizimit të transmetimeve të paautorizuara dhe në raste shkeljesh, marrjen e sanksioneve dhe ekzekutimin e tyre ndaj operatorëve të ndryshëm.

Krahas inspektimit të planifikuar, për sinjalet radio e televizive që mund të kapen nga Tirana (kryesisht për sinjalet që mbulojnë hapësirën Tiranë-Durrës), kryhet monitorimi ditor, që regjistron gjendjen e transmetimeve radiotelevizive, e cila raportohet në fund të çdo jave.

Evidentimi i saktë dhe ndjekja e përditshme ka bërë që të mbahet nën kontroll regjimi i transmetimeve, sidomos në zonën e rënduar Tiranë-Durrës, ku, me të konstatuar një anomali, është ndërhyrë menjëherë për të stabilizuar situatën.

4.4.1 Operatorë radiofonikë privatë vendorë që kanë pasur ndërprerje të shpeshta të transmetimit.

Nga inspektimet nëpër rrethe, edhe këtë vit, janë konstatuar operatorë që kanë pasur ndërprerje të shpeshta të transmetimeve për arsye jo të justifikueshme: Radio “Sport”, Radio “AS”, Radio “Aldo 03”, Radio “Alfa & Omega” etj.

Operatori Radiofonik	Frekuenca	Ndërprerje të transmetimit ne ditë
Radio Sport	92	17
Radio AS	103,1	12
Radio Aldo 03	98,7	5
Radio Alfa & Omega	102,6	3

TV Lobi, TV Margit kanë sjellë si justifikime për ndërprerjet dhe defektet e shpeshta teknike, furnizimin jo të rregullt me energji elektrike.

4.5 TRANSMETIMET AKTUALE (PROBLEMATIKAT)

Miratimi i ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, rregulloi për herë të parë tregun e mediave radiotelevizive në Shqipëri. Me miratimin e këtij ligji u licencuan një numër i madh subjektsh radiotelevizive, të cilët, aktualisht, operojnë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Me gjithë përpjekjet e vazhdueshme të KKRT-së për të vendosur ligjshmërinë në tregun e transmetimeve radiotelevizive dhe pavarësisht sukseseve të arritura në këtë drejtim, që para miratimit të ligjit të sipërpërmendur e deri në ditët e sotme, vazhdon të ketë ende transmetime të paautorizuara.

Kështu, që në vitin 2004, ka filluar transmetimet numerike të paautorizuara platforma Digitalb, e cila vazhdon edhe sot. Gjithashtu, në treg operon pa licencë edhe platforma tjetër digjitale numerike Tring (në 23.01.2008 KKRT-ja ka lëshuar lejen e përkohshme për eksperimentimin e transmetimeve digjitale. Leja ka përfunduar më 24.07.2008) Gjithashtu, që prej gati një dekade, në tregun e mediave audiovizive në Shqipëri, bashkëjetojnë transmetime analoge dhe numerike.

Duke pasur parasysh se në vitin 2007 u miratua ligji nr. 9742 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë”, që rregullonte për herë të parë transmetimet numerike në vend, nga ana e KKRT-së u bënë përpjekje, në vitin 2008, për licencimin e platformave numerike nëpërmjet organizimit të garës. Gara u shpall në nëntor 2008 dhe afati i fundit për paraqitjen e aplikimeve u përcaktua data 24.11.2008. Pas disa shtyrjeve me kërkesën e disa operatorëve, nga KKRT-ja, si datë përfundimtare e paraqitjes së aplikimeve, u përcaktua data 21.01.2009.

Pavarësisht përpjekjeve të KKRT-së, nuk u arrit zhvillimi i garës, pasi operatorët e palicencuar të platformave numerike nuk morën pjesë në garë, duke refuzuar kështu përfshirjen e tyre në procesin e licencimit.

Gjithashtu, për të sjellë operatorët numerikë në parametrat ligjore, prej janarit 2008 u lejuan, sipas kërkesës së tyre, dy transmetime eksperimentale numerike (Shijak TV dhe Vizion Plus), për një kohë prove prej gjashtë muajsh. Pas mbarimit të kësaj periudhe (24.07.2008) eksperimentale, edhe këta operatorë vazhduan transmetimet, por pa shprehur më interes për të rregulluar situatën e tyre në harmoni me ligjin.

Theksojmë se pamundësia e licencimit të operatorëve numerikë ka krijuar vështirësi për monitorimin dhe kontrollin e tyre.

Problem tjetër paraqesin edhe televizionet analoge, të cilat paralelisht transmetojnë simulcast (në të njëjtën kohë edhe në mënyre analoge edhe numerike). Këta operatorë nuk përmbushin kërkesat e licencës për mbulimin e territorit që u është caktuar, por, duke përdorur platformat numerike, ata shtrihen jo vetëm në zonat për të cilat janë licencuar, por edhe përtej këtyre zonave. Kjo situatë e bën të vështirë kontrollin nga KKRT-ja, në lidhje me respektimin e zonave të licencimit nga ana e operatorëve televizivë.

Në maj të vitit 2012, Këshilli i Ministrave miratoi Strategjinë për kalimin në transmetimet numerike, Strategji e cila, ndërmjet të tjerash, parashikon edhe rregullimin e situatës së transmetimeve të paautorizuara numerike.

Në zbatim të kësaj Strategjie, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka njoftuar zyrtarisht operatorët në lidhje me afatin e kalimit të transmetimeve numerike, si dhe për hapat dhe procedurat që duhen ndërmarrë për realizmin e këtij kalimi. Ndërkaq, janë kryer takime publike dhe konferenca kombëtare, me të gjithë operatorët, lidhur me zbatimin e Strategjisë.

Zbatimi i Strategjisë dhe miratimi i projektligjit “Për mediat audiovizuale në Republikën e Shqipërisë”, do t’i hapte rrugë realizmit të procesit të kalimit në sistemin numerik, përfshirë edhe rregullimin e transmetimeve numerike ekzistuese të paautorizuara.

Rregullimi i situatës së mësipërme parashikohet si në Strategjinë e kalimit në transmetimet numerike, (miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012) ashtu edhe në projektligjin “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Më konkretisht, në Strategji (faqe 20, § 2.3 Digjitalizimi i rrjeteve të operatorëve privatë kombëtarë) është parashikuar që, për kalimin në transmetimet numerike, “...zgjidhja më e përshtatshme do të ishte licencimi i operatorëve ekzistues bazuar në kushtet e vendosura nga ligji dhe rregullave të përcaktuara nga KKRT-ja”. Në mënyrë më të hollësishme, ky proces është shpjeguar në kërret 4.7; 4.8 dhe 4.9 të këtij Raporti.

Më poshtë paraqiten zonat e mbulimeve të palicencuara për çdo subjekt televiziv.

Transmetime Numerike:

ALBANIA SCREEN



**DVB-T: SARANDË
TELE JON**



DVB-T - PESHKOPI




Pika Transmetuese



Mbulimi me sinjal

DIGITALB



TV KLAN



TRING



Pika Transmetuese



Mbulimi me sinjal

HD - DIGITALB



TVSH



TV Vizion +



Pika Transmetuese



Mbulimi me sinjal

Transmetime Analoge:

- Operatori Vizion+




Zona e Licensimit




Zona e Paautorizuar

- Operatori TV ABC News



- Operatori TV UFO Education:



4.6 OPERATORËT

4.6.1 Operatorët radio e televizivë që mbështeten në rrjete tokësore analoge

4.6.1.1 Televizioni publik

RTSH ka në funksionim 36 transmetues VHF, 29 transmetues UHF dhe një rrjet sekondar prej 210 përsëritësish.


Kombinimi i mbulimeve të realizuar nga transmetuesit, që emetojnë sinjal në VHF, transmetuesit e rrjetit primat në UHF dhe përsëritësve, bëjnë që mbulimi me sinjalin e RTSH të territorit të Republikës të arrijë në mbi 87 %.

Problem kryesor mbetet bashkërendimi i punës me organet e pushtetit lokal për mirëmbajtjen e përsëritësve (mungesë godinash, linjash elektrike dhe pagesa kujdestarësh).


Rrjeti TVSH 2 vazhdon të mbulojë vetëm zonën Tiranë-Durrës me 47%, ndërsa *“...duhet të mbulojë territorin e banuar nga të paktën 90% e shtetasve të Republikës së Shqipërisë”* (nenet 70 dhe 71 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar).

Figurat e mëposhtme (Fig. 5 dhe 6) pasqyrojnë mbulimin e territorit shqiptar me sinjalin e TVSH-së.

Pikat transmetuese te TVSH-se ne brezin VHF deri ne fund te vitit 2012



Page 54



Pikat transmetuese te TVSH-se ne brezin VHF deri ne fund te vitit 2012




Fig. 5 Mbulimi me sinjal analog tokësor në bandën VHF, i realizuar nga TVSH

Mbulimi i TVSH-së në brezin UHF deri në fund të vitit 2012




Fig.6 Mbulimi me sinjal analog tokësor në bandën UHF, realizuar nga TVSH

4.6.1.2 Operatorët privatë kombëtarë

Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë në vite të zgjerimit të mbulimit të territorit të Republikës me sinjale të operatorëve kombëtarë radio e televizive, krahasuar me detyrimet për mbulim të vendosura në kushtet e licencës së secilit prej tyre.

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

Vitet	Emërtimi	TVSH	Radio Tirana	TV Klan	R.Top Albania	Radio +2	TV Top Channel
		Publik	Publik	Viti lic. 2001	Viti lic. 2001	Viti lic. 2002	Viti lic. 2008
2002	Viti i lic. apo rilic.	----	----	2	2	-----	-----
	Kushtet e licencës	----	-----	7.33	28.85	-----	-----
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	40.91	87.22	-----	-----
2003	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	3	3	1	-----
	Kushtet e licencës	----	-----	26.4	55.76	10.11	-----
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	42.68	87.22	72.64	-----
2004	Viti i lic. apo rilic.	-----	-----	4	4	2	
	Kushtet e licencës	----	-----	46.97	72.69	28.87	-----
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	42.68	87.22	72.64	-----
2005	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	5	5	3	
	Kushtet e licencës	----	-----	62.09	94.4	55.76	-----
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	42.68	87.22	72.64	-----
2006	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	6	6	4	
	Kushtet e licencës	----	-----	75.71	90	72.68	-----
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	44.53	87.22	72.64	-----
2007	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	7	0	5	-----
	Kushtet e licencës	----	-----	86.86	90	94.4	-----
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	44.53	87.22	72.64	-----
2008	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	8	1	0	1
	Kushtet e licencës	----	-----	90	90	90	50
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	69.8	87.22	72.64	62.1

2009	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	1	2	1	2
	Kushtet e licencës	----	-----	90	90	90	50
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	70.2	87.22	72.64	62.1
2010	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	2	3	2	3
	Kushtet e licencës	-----	-----	90	90	90	90
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	70.2	87.22	72.64	62.1
2011	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	3	4	3	4
	Kushtet e licencës	-----	-----	90	90	90	90
	Mbulimi faktik %	75	80.54	78	93.7	72.64	79.4
2012	Viti i lic. apo rilic.			4	5	4	5
	Kushtet e licencës	-----	-----	90	90	90	90
	Mbulimi faktik %	87	80.54	78	93.7	68	79

Tab.3 Zgjerimi i mbulimit të territorit të Republikës me sinjale të operatorëve kombëtarë radio e televizivë

Nga inspektimet e kryera gjatë vitit është konstatuar që stacione transmetuese, në pika të caktuara, kanë rezultuar të fikura.

Operatori kombëtar Radio+2, edhe gjatë vitit 2012, ka pasur probleme në sigurimin e transmetimeve sistematike në disa zona të vendit. Nga inspektimet e kryera janë konstatuar mungesa të sinjalit të Radio +2 sidomos në zona të largëta si Saranda etj. KKRT-ja i ka tërhequr vëmendjen shkresërisht kësaj radioje, duke i kërkuar edhe arsyet e mungesës së sinjalit.

4.6.1.2.1 Operatori kombëtar TV KLAN

Operatori kombëtar TV KLAN mbulon 78 % të territorit të Republikës së Shqipërisë me sinjal të vazhdueshëm e me cilësi. Ky operator ka vendosur stacione transmetues në 33 pika që mbulojnë gjithë territorin shqiptar.

TV Klan transmeton nga studio fikse në qytetet e Shkodrës, Durrësit, Korçës, Elbasanit dhe Vlorës.

Programi i operatorit “Klan”, duke u mbështetur edhe në platformë satelitore, si dhe në rrjetin numerik tokësor të “Digitalb”-it, mund të konsiderohet se mbulon gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.





Fig.7 Pikat e transmetimit të TV KLAN sipas licencës

Pikat transmetuese teTV Klan deri ne fund te vitit 2012






Fig. Mbulimi me sinjal analog tokësor, realizuar nga TV KLAN

4.6.1.2.2 Operatori kombëtar TV TOP CHANNEL

TCH mbulon 79 % të territorit të Republikës së Shqipërisë.

Instalimi i stacioneve transmetues shtesë në pika të reja, sipas planit që përmban licenca, ka përmirësuar ndjeshëm mbulimin me sinjal të realizuar nga ky operator. Figura e mëposhtme pasqyron ndryshimet në numrin e pikave transmetuese në funksionim. Më poshtë jepen të dhënat për pikat e transmetimit dhe mbulimin e realizuar nëpërmjet rrjetit analog tokësor të TV “Top Channel”.

Programi i operatorit “Top Channel”, duke u mbështetur edhe në platformë satelitore, si dhe në rrjetin numerik tokësor të “Digitalb”-it, mund të konsiderohet se mbulon gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.




Fig. Pikat e transmetimit të TV TOP CHANNEL sipas licencës

Pikat e transmetimit të TV “Top Channel” deri ne fund te vitit 2012




Fig. 9 Pikat e transmetimit të TV TOP CHANNEL në fund të vitit 2012




Fig. Mbulimi me sinjal analog tokësor në bandën UHF, realizuar nga Top Channel

4.6.1.3 Operatorët privatë vendorë

Edhe gjatë vitit 2012, peizazhi audiovizual në Shqipëri u plotësua me operatorë të rinj radio (FM) dhe televizivë tokësorë të teknologjisë analoge.

Po kështu, edhe në vitin 2012, asnjë operator vendor nuk ka raportuar për investime për përmirësimin e mbulimit me sinjal të zonës së tyre të licencimit. Përkundrazi, janë konstatuar raste kur mbulimi i zonës është reduktuar, si dhe, në disa raste ekstreme, mbulimi është ndërprerë në të gjithë zonën. TV Riviera Vlorë, që është licencuar për qarkun e Vlorës, edhe gjatë vitit 2012, ka mbuluar vetëm Sarandën; TV 2A, Kavajë, ka ndërprerë transmetimet për një kohë të gjatë për të gjithë qytetin e Kavajës, për mbulimin e të cilit është licencuar. TV France 5 (TV me përsëritës) nuk ka qenë në shërbim për një kohë të gjatë në Vlorë. Po kështu, TV REX (kanali 56 Korçë) nuk është evidentuar në transmetim në asnjë nga inspektimet e KKRT-së dhe është në procedurë administrative për sjelljen në parametrat ligjore.

Mbulimi i realizuar nga operatorët radio e televizivë, në zonën e tyre të licencimit, jepet nga hartat bashkëngjitur në Aneksin 3 dhe 4.

Në lidhje me mbulimet e operatorëve radio e televizivë, të paraqitura në Aneksin 3 dhe 4, sqarohet se dhënia e një panorame të saktë është mjaft e vështirë.

Kjo sepse, për të dhënë një përqindje të saktë të mbulimit, këta operatorë duhet të kontrollohen në mënyrë sa më të shpeshtë. Duke pasur parasysh se nga studioja e monitorimit, në KKRT, mund të kontrollohen *on line* vetëm operatorët e zonës Tiranë – Durrës, pjesa tjetër e operatorëve kontrollohet nëpërmjet inspektimeve në terren.

Për shkak të kapaciteteve të kufizuara të KKRT-së (si në burime njerëzore, ashtu edhe në ato materiale), inspektimi sa më i shpeshtë në terren, i të njëjtëve operatorë, paraqitet mjaft i vështirë. Pikërisht për këtë arsye në Aneksin 3 jepet mbulimi për 89 % të operatorëve televizivë, të cilët janë monitoruar gjatë vitit 2012 dhe në Aneksin 4 jepet mbulimi për 51% të operatorëve radio, të cilët janë monitoruar gjatë vitit 2012.

Për sa i përket analizimit të të dhënave në lidhje me përqindjen e mbulimit të operatorëve, ka rezultuar që disa operatorë televizivë vendore nuk e mbulojnë plotësisht zonën e tyre të licencimit. Arsyt kryesore, të paraqitura nga operatorët për mosrespektimin e këtij kushti të licencës, kanë qenë:

- a) Stacionet transmetues televizive janë fikur për shkak të mungesës së energjisë elektrike;
- b) Defekte në pajisjet e transmetimit, (djegie e aparaturave për shkak të motit të keq) të cilat kanë dashur kohën e tyre të nevojshme për riparim;

Po kështu, pavarësisht se në licencën e miratuar planifikimi për mbulim me sinjal ka qenë parashikuar të bëhej duke përdorur disa pika transmetuese, gjatë inspektimit në terren ka pasur raste që jo të gjitha stacionet në këto pika kanë rezultuar të ndezura.

Së fundi, niveli i ulët i mbulimit të disa operatorëve vendorë, mund të shpjegohet edhe me faktin se, gjatë viteve, operatorët nuk kanë bërë përpjekje dhe investime për të përmirësuar mbulimin në zonat e pambuluara, për shkak të konfiguracionit të thyer të terrenit (pjesë të mëdha të zonës së licencimit shtrihen në terren malor dhe mbulimi i plotë i këtyre zonave kërkon shtimin e pikave transmetuese). Kjo ka lidhje edhe me momentin e parë të licencimit, kur operatorët, ndonëse kishin ndezur nga një transmetues, u licencuan për zona më të gjera sesa mund të mbuloheshin me një transmetues.

Gjithsesi, duke qenë se sa më sipër ka qenë një situatë e mbartur prej shumë vitesh, KKRT-ja, duke pasur parasysh detyrimin e kalimit në transmetimet digjitale, (të përcaktuara si në Strategji, ashtu edhe në projektligj) nuk ka këmbëngulur që të detyrojë operatorët të shtojnë transmetuesit analogë.

4.6.1.4 Interferenca ndaj shërbimeve të tjera shkaktuar nga operatorë Radiotelevizivë

Gjatë vitit 2012, nga operatori telefonik Vodafone Albania, janë paraqitur ankesa për interferencë, të shkaktuara nga stacione të operatorëve televizivë në brezin GSM 900 MHz. Nga inspektimet e ushtruara nga Drejtoria Teknike, në bashkëpunim me AKEP-in,

ka rezultuar se disa nga stacionet e instaluara nga operatorët televizivë (TV Apollon (Fier), TV Fokus, TV Amantia dhe TV 6+1 (Zvërnec) transmetonin jashtë standardeve teknike, duke shkaktuar ndërhyrje në brezin GSM 900 MHz, brez që përdoret në shërbimet e telefonisë së lëvizshme. Operatorët u njoftuan nga KKRT-ja për interferencën që shkaktonin, duke iu kërkuar të sillnin menjëherë në normë parametrat teknikë të transmetimit. Reagimi nga ana e tyre ishte i menjëhershëm dhe brenda 7 ditëve u bë e mundur sjellja e transmetimeve brenda standardeve, gjë që solli edhe eliminimin e interferencës.

4.7 PËRGATITJET PËR TRANSMETIMET NUMERIKE

4.7.1 Puna përgatitore për zbatimin e projektit të strategjisë së kalimit të plotë në transmetimet numerike

Strategjia e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012.

Një nga veprimtaritë kryesore të KKRT-së, për vitin 2012, ka qenë vënia në zbatim e Planit të Implementimit të Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në ato Numerike. Bazuar në këtë Plan, KKRT-ja ka detajuar detyrat që i përkasin, duke hartuar një Plan të saj të brendshëm me detyra e afate të përcaktuara për çdo drejtori.

Me gjithë punën paraprake të realizuar, mungesa e miratimit të ligjit të ri për mediat në Republikën e Shqipërisë ka penguar në realizimin e detyrave në afatet e përcaktuara në Planin e Implementimit, bashkëngjitur Strategjisë së miratuar.

Pavarësisht mungesës së shkaktuar nga vonesa e ligjit të ri, KKRT-ja ka punuar intensivisht për parapërgatitjen e të gjitha akteve nënligjore të nevojshme, me qëllim që ato të jenë gati për miratim, me ndonjë ndryshim eventual, menjëherë pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri.

Për implementimin me sukses të Strategjisë së miratuar, KKRT-ja, ndër të tjera, ka punuar për të sensibilizuar e aktivizuar të gjithë segmentet e tregut mediatik, me qëllim realizimin e një procesi të shpejtë dhe pa shqetësime për konsumatorin.

Në këtë kuadër, KKRT-ja iu është drejtuar shkresërisht si operatorit publik, ashtu edhe atyre privatë (kombëtarë e vendorë), duke i informuar për detyrimet e përcaktuara nga dokumenti i Strategjisë dhe duke i kërkuar bashkëpunimin në realizimin e këtij objekti prioritar për sektorin e mediave audiovizive në Shqipëri.

4.8 Detyrat për Radiotelevizionin Shqiptar

Për marrjen në kohë të masave për implementimin pa vonesë të Strategjisë së miratuar, KKRT-ja iu drejtua fillimisht RTSH-së, që është baza e implementimit të Strategjisë së kalimit në transmetimet numerike në Shqipëri.

Çështjet për të cilat është kërkuar kontributi dhe bashkëpunimi i RTSH-së, kanë qenë si vijon:

1. Përcaktimi i kriterëve dhe numrit të programeve me karakter publik që do të transmetohen hapur (pa pagesë).

Siç përcaktohet në dokumentin e Strategjisë (faqe 34, § 2.8.2 Licencimi i rrjeteve dhe programeve të operatorit publik): *“Programet që vlerësohen si programe që përmbushin misionin publik të RTSH-së, transmetohen hapur (free to air). Këto programe, pas një konsultimi publik, me propozim të operatorit publik, miratohen nga Autoriteti Kompetent i përcaktuar në ligj”*.

Për plotësimin e kësaj detyre është kërkuar bashkërendimi i punës për:

- a) përcaktimin e kriterëve për klasifikimin e programeve si program me karakter publik;
- b) përgatitjen e listës me programet e propozuara si programe publike;
- c) organizimin e konsultimit publik;
- d) vendimmarrjen mbi numrin dhe emërtimin e kanaleve publike, si dhe shpenzimet e nevojshme për mbështetjen e këtyre programeve.

2. Përcaktimi i kriterëve dhe numrit të programeve me akses të kushtëzuar (me pagesë)

Po sipas dokumentit të Strategjisë (fq. 34, § 2.8.2 Licencimi i rrjeteve dhe programeve të operatorit publik): *“RTSH-ja mund të ofrojë edhe programe me akses të kondicionuar për të konkurruar në tregun mediatik, në përputhje me disponibilitetin e vendeve të lira në platformë (rrjet), mundësive financiare dhe pas përfundimit të fazës së parë të procesit të digjitalizimit (pas mbylljes së transmetimeve analoge). Programet me akses të kushtëzuar nuk përfitojnë nga skema publike e financimit të RTSH-së. Financimi i tyre bëhet krejtësisht nga reklamat dhe abonentët e shërbimit me akses të kushtëzuar”*.

Për plotësimin e kësaj detyre është konsideruar i nevojshëm bashkërendimi i punës për:

- a) përcaktimin e kriterëve dhe tematikës për programet me akses të kushtëzuar;
- b) përgatitjen e biznes planit për rentabilitetin e programeve me akses të kushtëzuar;
- c) vendimmarrjen mbi numrin dhe biznes planin e shërbimeve me akses të kushtëzuar.

3. Parimet dhe kriteret e kontratave që do të lidhen midis RTSH-së dhe operatorëve privatë lokalë ekzistues për mbështetjen në rrjetin e operatorit publik (MUX 1).

Strategjia (fq. 22, § 2.4 Digjitalizimi i rrjeteve të operatorëve privatë vendorë) përcakton: *“Kombinimi i ndërtimit të rrjetit të operatorit publik me ndërtimin e rrjeteve të operatorëve vendorë mund të jetë një rrugë që do të shkurtojë kostot e përgjithshme të kalimit në numerik. Kjo do të sigurojë mbështetjen e të gjithë operatorëve ekzistues lokalë në platformën numerike të transmetuesit publik”*.

Për realizimin e mbështetjes së operatorëve analogë ekzistues në rrjetin e TV publik është i nevojshëm hartimi i kontratës tip, midis këtij të fundit dhe secilit prej operatorëve privatë lokalë, e cila do të rregullojë marrëdhëniet midis palëve, do të përcaktojë detyrat dhe të drejtat e secilës palë, mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve etj.

4. Kriteret e përcaktimit të pagesave të operatorëve privatë ekzistues analogë për mbështetje në rrjetin numerik të TVSH-së dhe përcaktimi i pagesave për çdo kategori.

Dokumenti i Strategjisë (Kapitulli 7) përcakton metodologjinë e llogaritjes së pagesave që do të kryejnë operatorët analogë ekzistues për mbështetjen në rrjetin e RTSH-së. Në

mënyrë specifike § 7.7. përmban propozime mbi lehtësimin e pagesave për mbështetjen e operatorëve ekzistues në rrjetin numerik të TVSH-së.

Për hartimin e kriterëve dhe të pagesave përkatëse për çdo zonë të Shqipërisë është e nevojshme:

1. Përcaktimi i kostos së ndërtimit të rrjetit numerik të RTSH-së (MUX 1), bazuar në projektin konkret që do të hartohet nga RTSH-ja;
2. Përcaktimi i numrit minimal të programeve që do të mbështeten në MUX 1 (për programet e RTSH-së dhe për programet privatë lokalë);
3. Përcaktimi i shpenzimeve vjetore për mirëmbajtjen e rrjetit numerik të RTSH-së (MUX 1);
4. Përcaktimi i pagesave të diferencuara sipas zonave.

5. Objektivat e mbulimit

Dokumenti i Strategjisë (fq. 19, § 2.1.3 Objektivi i mbulimit) përcakton se: *“Objektivi minimal i digjitalizimit do të jetë realizimi i mbulimit me sinjal të popullsisë, të paktën në masën që ky mbulim realizohet me teknologjinë analoge nga secili operator.*

...Objektivi i mbulimit të realizuar me anë të rrjetit numerik të RTSH-së në përfundim të fazës së parë të digjitalizimit do të jetë: Mbulimi i 75 % të territorit dhe 85 % të popullsisë”.

Bazuar në projektin teknik, që do të hartohet nga RTSH-ja, do të studiohen mundësitë për avancimin e këtij objekti.

6. Karakteristikat kryesore teknike të rrjetit:

Dokumenti i Strategjisë (§ 2.6 Karakteristikat teknike) përcakton:

2.6.1 Tipat e rrjeteve	11 SFN
2.6.2 Sistemi i transmetimit	DVB-T2
2.6.3 Standardet e kompresimit	MPEG 4 H.264/AVC

Mbështetur në përcaktimet e strategjisë, karakteristikat kryesore të rrjetit numerik të RTSH-së (MUX 1) do të jenë:

Brezi i frekuencave	470 – 790 MHz
Gjerësia e kanalit	8 MHz
Standardi	DVB -T 2
Tipi i rrjetit	SFN
Rrjeti	11 SFN
Rrjeti referencë	RN2
Konfiguracioni i planifikimit	RPC 2
Modulimi	64-QAM
Intervali mbrojtës	¼ 19/256, 1/8, 19/128, 1/16, 1/32, 1/128
Definicioni	SD
Standardi i kompresionit video	MPEG 4 H.264/AVC ETSI TS 101 154 [3]
Standardi i kompresionit audio	MPEG 1 Layer II ("Musicam" ISO/IEC 11172-3)
Aksesi i kushtëzuar	JO

7. Hartimi i Projektit Teknik të Rrjetit Numerik të RTSH-së (MUX 1)

Bazuar në dokumentacionin e përcaktuar nga KKRT-ja (karakteristikat teknike të rrjetit, caktimet frekuencore me karakteristikat përkatëse, specifikimet e marrësit), RTSH-ja do të përgatisë projektin teknik të rrjetit, i cili, pas miratimit në Këshillin Drejtues të RTSH-së, do të paraqitet në KKRT.

8. Caktimi i pikave të instalimit të MUX-eve lokalë në qendrat e allotmenteve

- a. Caktimi i ambienteve të RTSH-së në qendrat e allotmenteve Kukës, Lezhë, Elbasan, Fier, Vlorë, Berat, Dibër;
- b. Instalimi i pajisjeve të RTSH-së;
- c. Marrëveshjet me operatorët lokalë për sjelljen e sinjaleve në MUX.

9. Implementimi i rrjetit të parë numerik (MUX 1)

- a. Sigurimi i financimit të projektit (RTSH);
- b. Hapja e garës për ndërtimin e rrjetit dhe përcaktimi i fituesit (RTSH);
- c. Grafiku i ndërtimit të “ishujve numerikë” (RTSH-KKRT);
- d. Organizimi i testeve të marrjes së sinjalit numerik në pika të ndryshme të allotmentit (RTSH-KKRT);
- e. Marrja në dorëzim e rrjetit (RTSH-KKRT).

10. Koordinimi me operatorët privatë lokalë për mbështetjen e tyre në MUX 1

- a. Koordinimi me operatorët privatë për përcaktimin e detajeve teknike të sjelljes së sinjaleve të tyre në qendrat e allotmenteve (RTSH-KKRT);
- b. Caktimi i grafikut të përfundimit të linjave operatorëve privatë -Head End i RTSH-së;
- c. Ndjekja e problemeve teknike gjatë periudhës simulcast (RTSH, Operatorë lokalë privatë, KKRT);
- d. Marrja e vendimit për mbylljen e transmetimeve analoge (RTSH, Operatorë lokalë privatë, KKRT).

4.9 Detyrat për operatorët ekzistues historikë analogë

Në shkresën për operatorët ekzistues historikë analogë, që mund të pretendojnë për një licencë kombëtare, theksohej se, sipas Strategjisë, procesi i kalimit në transmetime numerike, të operatorëve kombëtarë historikë dhe operatorëve me eksperiencë në transmetimet numerike, do të realizohet përmes aplikimit të praktikës *beauty contest* (licencim me kërkesa të kufizuara me qëllim mbështetjen e peizazhit mediatik ekzistues).

KKRT-ja, bazuar në zhvillimet e tregut të transmetimeve audiovizive, do të përcaktojë operatorët privatë kombëtarë si dhe operatorët ekzistues me eksperiencë në transmetimet numerike që do të ftohen të marrin pjesë në procedurën e përzgjedhjes sipas *beauty contest*-it për rrjetet numerike kombëtare. KKRT-ja, brenda afatit që do të caktohet në ligjin për mediat audiovizive, do të bëjë njoftimin publik dhe do të ftojë operatorët për të marrë pjesë në procesin e përzgjedhjes.

Në dokumentin e Strategjisë është sanksionuar që operatorët privatë kombëtarë, si dhe operatorët ekzistues me eksperiencë në transmetimet numerike, të përzgjedhur nga KKRT-ja, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

1. Të lirojnë frekuencat e zëna arbitrarisht, nëse operojnë në kushte të tilla, dhe të migrojnë në frekuencat e përcaktuara në Planin Numerik (GE 06), sipas specifikimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, brenda një kohe të përcaktuar në licencë.
2. Të aplikojnë sistemin DVB-T2 me standard kompresioni MPEG-4. Kalimi nga sistemi DVB - T, MPEG - 2 në DVB - T2, MPEG - 4 do të bëhet jo më vonë se tre vjet nga momenti i licencimit;
3. Mbështetjen e rrjeteve të operatorëve vendorë për programet si dhe për bashkëpërdorimin;

Me qëllim që të parapërgatiten për zbatimin e detyrave të parashikuara në planin e veprimit të Strategjisë, nga KKRT-ja u është kërkuar operatorëve të merren masat e mëposhtme:

1. Të njoftojnë zyrtarisht KKRT-në, brenda afatit që do të përcaktohet nga ftesa e këtij të fundit, mbi interesin e subjektit tuaj për t'u licencuar për transmetime numerike tokësore kombëtare (në rast mungese të përgjigjes, do të konsiderohet si refuzim i ftesës me pasojë mosdhënien e licencës);
2. Në letrën e interesit, subjekteve u është kërkuar të pasqyrojnë programet që parashikojnë të mbështesin në rrjetin DVB-T2, duke respektuar raportin midis programeve të veta dhe të të tretëve, llojin e programeve (HD-SD), programet që do të transmetohen hapur dhe ato me akses të kushtëzuar etj;
3. Të parashikojnë periudhën e tranzicionit për kalimin nga sistemi DVB - T, MPEG - 2 në DVB - T2, MPEG - 4 si dhe afatin e lirimit të frekuencave të Dividentit Digjital. Periudha më e shkurtër e parashikuar do të konsiderohet kriter favorizues;
4. Të parashikojnë parimet dhe kriteret e kontratave që mund të lidhin me ofruesin e shërbimit të programit audioviziv, çmimet e mbështetjes së tyre në rrjetin e subjektit, si dhe pikat e aksesit.

4.10 Detyrat për operatorët ekzistues analogë privatë lokalë

Në shkresën për operatorët ekzistues analogë privatë lokalë, pasi përmendej se: “Në dokumentin e Strategjisë (reflektuar edhe në projektligjin që është në proces miratimi) është parashikuar që për kalimin në transmetime numerike: “...Operatorëve privatë ekzistues lokalë do t'u paraqiten alternativat e mëposhtme:

1. Mbështetje në rrjetin e operatorit publik;
2. Financimi i përbashkët prej operatorëve ekzistues në përbërje të një allotmenti për ndërtimin e rrjetit numerik dhe shfrytëzimin e përbashkët të kapaciteteve të lira të tij (kërkohet mbështetja ligjore);
3. Organizimi i garës për ndërtimin e rrjetit numerik lokal”;

kërkohej që nga ana e tyre: “të studioheshin alternativat e mësipërme dhe të vendosej alternativa që do të zgjidhej”. Vendimi duhej t'i njoftohej KKRT-së në afatin e përcaktuar nga kjo e fundit, duke theksuar se, pavarësisht alternativës së zgjedhur, realizimi i mbështetjes në rrjete numerike do të kryhet në përputhje me afatin e përcaktuar për ndërtimin e ishujve numerikë.

Në shkresë, operatorëve u jepeshin udhëzime mbi veprimet që duhen kryer pas zgjedhjes së alternativës:

1. Në rastin e zgjedhjes së alternativës së parë, Strategjia parashikon që lidhja e studiove të operatorëve ekzistues, që do të mbështeten në rrjetin e operatorit publik, do të realizohet me shpenzimet e veta.

“Në këtë rast operatorët:

1.1 Do të lidhin kontratë me TVSH-në;

1.2 Do të përgatisin projektin teknik për lidhjen e head end-eve lokale me atë qendror ku do të përcaktohet mënyra e lidhjes (me sisteme kabllor, fibra optike, ose me sisteme mikrovalor). Të gjitha *head end-et* lokale do të lidhen me atë qendror për të siguruar shpërndarje kombëtare të programeve të operatorit publik. Për hartimin e projektit të lidhjes duhet të marrin kontakt me TVSH-në, për të përcaktuar vendndodhjen e *head end-it* të allotmentit.

2. Në rastin e zgjedhjes së alternativës së dytë, operatorët ekzistues analogë, që përfshihen brenda një allotmenti, duhet:

2.1 Të negociojnë për përgatitjen e marrëveshjes midis tyre për shfrytëzimin e përbashkët të rrjetit.

2.2. Të njoftojnë zyrtarisht autoritetin rregullator për arritjen e marrëveshjes.

Autoriteti rregullator, me vendim të veçantë do t’i japë, pa garë, licencë për transmetime numerike lokale, shoqërisë së re të krijuar nga bashkimi i subjekteve ekzistues. Licenca, ndër të tjera, përfshin kërkesat për programet, karakteristikat teknike dhe frekuencat përkatëse.

3. Në rast se operatorët dështojnë në arritjen e marrëveshjes, atëherë do të vijohet me alternativën e tretë, që është organizimi i konkurrimit për licencim për transmetime numerike lokale.

Për realizimin e mbështetjes së operatorëve analogë ekzistues në rrjetin e TV publik, është i nevojshëm **hartimi i kontratës tip** midis këtij të fundit dhe secilit prej operatorëve privatë lokalë, e cila do rregullojë marrëdhëniet midis palëve, do të përcaktojë detyrat dhe të drejtat e secilës palë, mënyrën e zgjedhjes së mosmarrëveshjeve, pagesat e operatorëve analogë ekzistues për mbështetjen në rrjetin e RTSH-së etj.

Modeli i kontratës tip sipas projektligjit do të miratohet nga autoriteti rregullator

5. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE, MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE PUBLIKUN

5.1. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ADMINISTRATIVE

Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe rritja e mëtejshme e performancës së administratës së KKRT-së, ka qenë dhe mbetet një objektiv i vazhdueshëm i punës së këtij institucioni, duke synuar pasjen dhe rekrutimin e punonjësve që të përballojnë sfidat dhe proceset që diktohen nga zhvillimet teknologjike si dhe plotësimin e standardeve dhe praktikave më të mira evropiane në fushën e medias.

➤ Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve administrative ka qenë pjesë edhe e rekomandimeve të dala nga takimi i katërt i Nën-komitetit BE-Shqipëri “Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale”, të zhvilluar më datë 29-30 qershor 2012, në Bruksel.

Në rekomandimet e dala nga ky takim, për sa i përket fushës së politikave audio-vizuale, ndërmjet të tjerash, është theksuar se *“kërkohen përpjekje të mëtejshme për të forcuar kapacitetet dhe pavarësinë e autoritetit rregullator”*. Nevoja e forcimit të kapaciteteve të KKRT-së është ritheksuar edhe në raportin e fundit të Komisionit Evropian (nëntor 2012).

Parë në këtë aspekt, KKRT-ja është përpjekur maksimalisht të krijojë një administratë efikase, të aftë për të përballuar dhe realizuar objektivat dhe detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor aktual si dhe për të kryer me sukses hapat e mëdha që priten të realizohen në të ardhmen në kuadër të kalimit nga sistemi analog në atë numerik.

KKRT-ja, është në pritje të miratimit të projekt-ligjit të ri të medias audiovizuale, gjë që do t'i hapte rrugë paraqitjes në Kuvend të propozimit për një strukturë efikase dhe me fleksibilitet më të madh për të menaxhuar dhe zgjidhur problemet dhe çështjet që hasen si pasojë e zhvillimeve teknologjike në fushën e medias, si dhe për përballimin e sfidave që mbart procesi i kalimit në sistemin numerik.

➤ Gjatë këtij viti raportues, Komisioni i Shërbimit Civil (KSHC), si organi i ngarkuar me mbikëqyrjen e menaxhimit të shërbimit civil, ushtroi për herë të parë një kontroll mbi mënyrën e menaxhimit të shërbimit civil në institucionin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

Ky kontroll u realizua gjatë periudhës maj-qershor 2012, dhe në përfundim të këtij procesi, u hartua dhe raporti përfundimtar në të cilin vlerësohej puna e bërë nga Institucioni sidomos për sa i përket realizimit të konkurseve për pranimin në shërbimin civil, hartimit të përshkrimeve të punës, procesit të vlerësimeve vjetore, mbarëvajtjes së

dosjeve të nëpunësve civilë dhe regjistrit të personelit etj, si dhe parashtroheshin disa rekomandime për zbatimin e të cilave u la një afat dy mujor.

Gjithashtu, gjatë muajit nëntor 2012, për të monitoruar nga afër zbatimin e këtyre rekomandimeve, grupi i mbikëqyrjes të Komisionit të Shërbimit Civil realizoi edhe një kontroll të dytë, pas të cilit ata vlerësuan angazhimin dhe punën e bërë nga institucioni në këtë drejtim.

➤ Trajnimi i nëpunësve civile është një element shumë i rëndësishëm i legjislacionit në fushën e shërbimit civil dhe nga niveli i zbatimit të tij mund të vlerësohet edhe niveli cilësor i administratës së këtij institucioni në realizimin e misionit të tij.

Parë në këtë këndvështrim, edhe për vitin 2012, në bashkëpunim me Institutin e Trajnimit të Administratës Publike (ITAP), u bë e mundur pjesëmarrja e punonjësve të KKRT-së në trajnimet që ky Institut organizon për nëpunësit e administratës publike, duke bërë të mundur trajnimin e rreth 20 (njëzet) punonjësve në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin e administratës publike, menaxhimin e projekteve dhe financave publike, çështjet e integritetit evropian, mbrojtjen e të dhënave personale etj.

Përpyekjet janë bërë edhe për pjesëmarrjen dhe trajnimin e stafit të institucionit në takime dhe seminare të organizuara nga organizmat dhe partnerët ndërkombëtarë në fushën e medias elektronike, ku mund të përmenden veçanërisht takimet që janë organizuar, në vazhdimësi, në kuadër të projektit “**Televizioni Digjital i Evropës Juglindore (SEE Digi TV)**”, brenda Programit të Bashkëpunimit Ndërnacional të Evropës Jug-lindore të financuar nga Bashkimi Evropian.

➤ Angazhimi i stafit të KKRT-së për të plotësuar detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritetit në Bashkimin Evropian, për sa i përket fushës së politikave audio-vizuale, ka qenë i vazhdueshëm dhe me prioritet maksimal. Në këtë kuadër, nga ana e institucionit është punuar në përgatitjen e hartimit të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA), 2012-2015, kapitulli 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media”.

Gjithashtu, gjatë vitit raportues, janë dërguar pranë Ministrisë së Integritetit informacione, raport-progres në lidhje me ecurinë e zbatimit të angazhimeve të marra apo rekomandimeve të dala nga takimet e zhvilluara me përfaqësues të Bashkimit Evropian.

➤ Kapacitetet monitoruese të institucionit vazhdojnë të jenë të njëjta. Institucioni nuk ka arritur të identifikojë burimet e nevojshme financiare për të mundësuar realizimin e një projekti konkret në këtë drejtim. Në kuadër të miratimit të projekt-buxhetit të institucionit për vitin 2013, u kërkuar planifikimi i një fondi të veçantë në këtë aspekt, kërkesë e cila deri më tani nuk është marrë në konsideratë.

Pajisja me mjedise të reja pune të KKRT-së mbetet një tjetër shqetësim permanent. Konstatohet se pavarësisht reagimit të vazhdueshëm për situatën në të cilën ndodhet institucioni, pas vendimit gjyqësor për lirimin e ambienteve të punës dhe kthimit të tyre

një subjekti privat, nuk është marrë asnjë veprim për të adresuar dhe zgjidhur këtë problem.

Edhe gjatë këtij viti raportues, është bërë një përpjekje e vazhdueshme për të krijuar kushte sa më optimale pune nëpërmjet organizimit, ndjekjes dhe realizimit të shërbimeve të ndryshme, për të plotësuar nevojat dhe për të zgjidhur problematikat e ndryshme të hasura gjatë punës së përditshme të institucionit.

5.2. MARRËDHËNIET ME JASHTË

Anëtarësimi i KKRT-së në disa organizma rajonale dhe ndërkombëtarë në fushën e medias elektronike, ka sjelle për rrjedhojë rritjen e kontakteve, shkëmbimin e vazhdueshëm të eksperiencave dhe praktikave evropiane dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

➤ Në kuadër të procesit të integritit evropian, takimet me përfaqësues të Shërbimeve të Komisionit Evropian, konsiderohen nga më të rëndësishmet. Në këtë kuadër, **në datën 29-30 qershor 2012, u zhvillua në Bruksel, takimi i katërt i Nën-Komitetit BE-Shqipëri “Mbi Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikën Sociale”**, në agjendën e të cilit u përfshinë edhe çështjet që lidheshin me fushën e medias elektronike.

Në këtë takim morën pjesë edhe përfaqësues të KKRT-së, të cilët paraqitën progresin e bërë nga institucioni si dhe hapat që do të ndërmerren në kuadër dhe të procesit të digjitalizimit.

Pas përfundimit të këtij takimi, u hartuan dhe u miratuan rekomandimet përkatëse, të cilat, për sa i përket fushës së politikave audiovizuale, konsistojnë në:

- *miratimin e ligjit për median audio-vizuale*
- *marrjen e masave të nevojshme për të siguruar zbatimin efektiv të strategjisë kombëtare për kalimin në transmetimet numerike*
- *rregullimin e përdorimit të frekuencave nga operatorët që operojnë pa licence*
- *forcimin e kapaciteteve dhe pavarësisë së autoritetit rregullator*
- *pavarësinë editoriale dhe qëndrueshmërinë financiare të transmetuesit publik*

➤ Në kuadër të zgjerimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit me autoritete rregullatore partnere, **më datë 8 maj 2012, u nënshkrua në Francë Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet KKRT-së dhe Këshillit Superior Audiovizual Francez (CSA)**. Ky memorandum përcakton mënyrat konkrete të bashkëpunimit, si dhe ofrimin e asistencës nga pala franceze, për procesin e kalimit në transmetimet numerike.

➤ **Më 25 maj 2012, në Tiranë, KKRT-ja, organizoi takimin vjetor të BRAF-it**, (Platforma e Autoriteteve Rregullatore Audiovizuale të Vendeve të Detit të Zi) dhe njëkohësisht mori drejtimin e këtij forumi të rëndësishëm rajonal. Iniciativa e BRAF-it, është pjesë integrale e Autoritetit për Kooperimin Ekonomik të Detit të Zi (BSCE). **Kjo**

është hera e parë që Shqipëria merr presidencën e kësaj organizate ndërkombëtare.

Kjo platformë, synon të rrisë dialogun dhe bashkëpunimin midis autoriteteve rregullatore për mediat elektronike të vendeve të Detit të Zi, dhe për të siguruar një forum për diskutimin e çështjeve me interes të përbashkët, të tilla si diversiteti kulturor dhe mbrojtja e pasurive kulturore.

➤ Në muajin gusht 2012, me qëllim për të siguruar një transparencë më të mirë dhe standarde llogaridhënie të një cilësie të lartë në menaxhimin e Marrëveshjeve të Grantit, **Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit nënshkroi me Delegacionin e Komisionit Evropian në Tiranë, një shtesë në kontratën e grantit, të firmosur gjatë vitit 2011**, në kuadër të projektit rajonal “Televizioni Dixhital i Europës Juglindore (SEE Digi TV)”. Më shumë informacion në lidhje ecurinë e zbatimit të këtij projekti do të gjeni në pikën e mëposhtme.

➤ Gjatë gjithë periudhës informuese, një element i rëndësishëm ka qenë dhe mbetet forcimi i marrëdhënieve me organizmat apo strukturat ndërkombëtare ku KKRT-ja është palë. Në këtë aspekt, vlen të theksohet forcimi dhe rritja e mëtejshme e bashkëpunimit me organizma të tilla si **EPRA** (Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullatore); **RIRM** (Rrjeti i Autoriteteve Rregullatore Mesdhetare); **REFRAM** (Rrjeti Frankofon i Autoriteteve Rregullatore); **ITU** (Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve); **BRAF** (Autoritetet Rregullatore të Vendeve të Detit të Zi) etj.

➤ Gjithashtu, një rëndësi e veçantë vazhdon t'i kushtohet forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve bilaterale me autoritetet rregullatore të vendeve të rajonit dhe më gjerë, me synim shkëmbimin e eksperiencave dhe përvojave sidomos për sa i përket procesit të kalimit në sistemin numerik. Në këtë aspekt, vlen të përmendet shkëmbimi i vazhdueshëm i eksperiencës dhe marrja e praktikave më të mira nga vendet që janë pjesë e projektit SEE Digi TV.

Përfaqësuesit e KKRT-së kanë qenë prezent dhe kanë dhënë kontributet e tyre në takimet e organizuara nga:

- **Konferenca Botërore e Radio-Komunikacionit WRC-12**, zhvilluar në 5-7 shkurt 2012 në Gjenevë, Zvicër. Gjatë kësaj konference u diskutua rreth rekomandimeve dhe rezolutave që kanë të bëjnë me transmetimet radiotelevizive dhe menaxhimin e frekuencave.
- **Takimi i pestë i Bordit Drejtues të projektit SEE Digi TV**, zhvilluar në datat 20-21 shkurt 2012, në Zagreb (Kroaci). Gjatë këtij takimi, u vlerësua progresi i bërë në ndjekje të aktiviteteve të projektit dhe u konfirmua fakti që zbatimi i projektit është në përputhje me kushtet e propozuara nga Programi i SEE. Vëmendja më e madhe në këtë takim, iu kushtua kuadrit të ndërgjegjësimit të publikut dhe kuadrit teknik.
- **Konferenca e parë ndërkombëtare në kuadër të projektit SEE Digi TV**, zhvilluar në datat 19-20 prill 2012, në Trieste (Itali). Gjatë konferencës u diskutua mbi tema të reja në lidhje me përfitimet e mundshme ekonomike nga dividendi digjital, menaxhimin e çështjeve ligjore dhe aspektet teknologjike në lidhje me

standardet dhe platformat e reja, si DVB-T2 dhe MPEG4, që po përdoren aktualisht nga disa vende evropiane dhe që do të shërbejnë si referencë për vendet të cilat janë ende të lidhura me modelin e mëparshëm DVB-T.

- **Seminari i organizuar nga UNESCO “Mbi statistikat në media”**, zhvilluar në 14-16 prill në Paris, Francë. Qëllimi i këtij seminari ishte trajnimi i grupit ndërkombëtar të punës (ku përfshihet edhe një përfaqësues nga KKRT-ja) për përpunimin e të dhënave në fushën e medias.
- **Takimi me Ministrinë e Punëve të Jashtme Franceze, Autoritetin Audiovizual (CSA), Televizionin “France 24”, “Tv5 Monde” dhe “Radio France International”** për vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe shkëmbimin e eksperiencave në fushën e digjitalizimit”, zhvilluar në 8-12 maj 2012 në Paris, Francë.
- **Takimi me Autoritetet Rregullatore të Rrjetit Frankofon (REFRAM) dhe pjesëmarrja në konferencën e 35-të të Platformës Europiane të Autoriteteve Rregullatore (EPRA)**, në 28-29 maj 2012 në Portoroz, Slloveni. Gjatë takimit të REFRAM u diskutua rreth propozimit të temave që do të trajtohen në konferencën vjetore të rrjetit. Në takimin e EPRA-s u diskutua rreth rregullimit të medias së re, medias lokale dhe të komunitetit, juridiksionit në lidhje me politikat audiovizuale dhe të ardhmen e komunikimit komercial.
- **Takimi i tretë teknik, në kuadër të Projektit SEE Digi TV**, zhvilluar në 5-6 qershor në Shkup, Maqedoni. Gjatë këtij takimi u diskutua ecuria e zhvillimit të aktiviteteve të parashikuara nga projekti.
- **Takimi i Komisionit Teknik, të Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullatore**, zhvilluar në 26 qershor 2012 në Lisbonë, Portugali. Qëllimi i takimit ishte identifikimi i tematikave që do të trajtoheshin në takimin vjetor të RIRM.
- **Takimi i Katërt, i Nën-Komitetit BE-Shqipëri mbi Inovacionin, Burimet Njerëzore, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikat Sociale**, zhvilluar në datat 28 - 29 qershor 2012, në Bruksel, Belgjikë. Në këtë takim u trajtuan, përveç të tjerash, edhe çështjet që janë pjesë e politikave të fushës audiovizuale.
- **Konferenca Ndërkombëtare “Digjitalizimi Tokësor Televiziv Praktik Evropiane dhe Rajonale ”** zhvilluar me datë 28 - 29 qershor 2012, në Prishtinë, Kosovë. Qëllimi i kësaj konference ishte shkëmbimi i eksperiencave midis vendeve të rajonit dhe diskutimi i çështjeve kryesore që shoqërojnë procesin e digjitalizimit.
- **Takimi i 7-të i Bordit Drejtues të Projektit SEE Digi TV**, zhvilluar në 13-14 shtator në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë. Gjatë këtij takimi u diskutua rreth ecurisë së aktiviteteve që janë zbatuar në shtetet partnere të projektit.
- **Takim mbi shkëmbimin e eksperiencave për zbatimin e strategjisë së digjitalizimit**, në datat 17-20 shtator 2012, në Helsinki, Finlandë. Ky takim u organizua nga autoriteti rregullator i Finlandës dhe kishte për qëllim ofrimin e eksperiencës së këtij autoriteti në lidhje me kalimin në sistemin numerik.

- **Konferenca e ITU Telecom World**, organizuar nga Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve, zhvilluar në datat 15–18 tetor 2012 në Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe. Në këtë konferencë u prezantuan zhvillimet më të fundit teknologjike për sa i përket fushës audiovizuale.
- **Konferenca e dytë ndërkombëtare në kuadër të Projektit SEE Digi TV**, zhvilluar në 17-20 tetor në Lubjanë, Slloveni. Diskutimet u fokusuan në çështjet kryesore me të cilat vendet partnere janë përballur gjatë implementimit të projektit. Një vëmendje e veçantë iu kushtua aspektit social të dividendit digjital.
